


# PLANI ZHVILLIMOR I KOMUNËS SË KLINËS

I.

*GJENDJA EKZISTUESE*

KOMUNA E KLINËS

URBAN PLUS – studio e planifikimit dhe dizjanit urban



# PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL I KLINËS

Projketi është inicuar dhe inancuar nga:



**KUVENDI  
KOMUNAL I  
KLINËS**

Projketi është hartuar nga:



Info:

**URBAN PLUS**

Studio e planifikimit dhe dizajnit urban

Adresa: Bulevardi "Nënë Tereza", 32/8

10000 Prishtinë, KOSOVË

tel: +381 (0)38 246056

e\_mail: [urbanplus@gmail.com](mailto:urbanplus@gmail.com)

# PËRMBAJTJA

## 1.0 HYRJE

PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL – ROLI DHE QASJA .....	7
ROLI DHE NATYRA E PLANIT .....	7
ROLI I PROFILIT KOMUNAL .....	8
QEVERISJA, PJESËMARRËSIT DHE ROLET E TYRE.....	8
PJESËMARRJA PUBLIKE .....	9
ROLET – VENDIMMARRËSE / JO-VENDIMMARRËSE .....	9

## 2.0 PROFILI I SITUATËS KOMUNALE

KOMUNA E KLINËS NË KOSOVË DHE RAJON .....	11
POZITA E KOMUNËS SË KLINËS NË KOSOVË .....	12
ZHVILLIMI HISTORIK .....	13
ZHVILLIMI INSTITUCIONAL .....	14
ADMINISTRIMI TERRITORIAL NË KOMUNËN ë KLINËS .....	15
QEVERISJA LOKALE .....	17
ZHVILLIMI SOCIAL .....	19
DEMOGRAFIA .....	19
LËVIZJA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË BANORËVE .....	19
DENDËSIA E POPULLSISË .....	21
SHTIMI NATYROR .....	22
LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË – MIGRIMET .....	23
STRUKTURA E POPULLSISË .....	23
STRUKTURA SIPAS MOSHËS .....	24
ZHVILLIMI SOCIAL SIPAS SEKTORËVE .....	25
ARSIMI .....	25
SHËNDETËSIA .....	29
SHËRBIMET ADMINISTRATIVE .....	30
SPORTI DHE REKREACIONI .....	30
KULTURA .....	30

ZHVILLIMI EKONOMIK .....	31
MJEDISI FIZIK .....	33
RRJETI I VENDBANIMEVE - GJENDJA NË NIVEL TË KOSOVËS .....	33
VENDBANIMET NË KOMUNËN E KLINËS .....	33
VENDBANIMET JOFORMALE .....	47
BANIMI SI FUNKSION DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE -	
TË FONDIT TË BANIMIT .....	49
OBJEKTET DHE LOKACIONET E TRASHËGIMISË KULTUORE .....	51
INFRASTRUKTURA .....	59
TRAFIKU DHE TRANSPORTI .....	59
RRJETI I UJËSJELLËSIT DHE KANALIZIMIT .....	63
RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKUES .....	65
MJEDISI NATYROR .....	69
KARAKTERISTIKAT RAJONALE .....	69
KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE TE KLINËS .....	70
KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE .....	70
KARAKTERISTIKAT SEIZMIKE .....	72
KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE .....	75
KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE .....	73
KARAKTERISTIKAT HAPËSINORE INXHINIERIKE .....	74
FLORA DHE FAUNA .....	75
RESURSET NËNTOKËSORE .....	76

## **1.0 HYRJE**

### **PLANI ZHVILLIMOR KOMUNAL – ROLI DHE QASJA**

Planifikimi në Kosovë gradualisht po e merr rolin meritor në procesin e zhvillimit. Me gjithë sfidat e qeverisjes lokale dhe mungesën e resurseve financiare dhe njerëzore, autoritet kanë vënë si prioritet hartimin e planeve për të cilat është kompetente komuna. Përkushtimi i Qeverisë së Kosovës për planifikim është artikular përmes angazhimeve të Ministrisë së Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor–MMPH dhe plotësimit të kornizës ligjore e cila përfshinë Ligjin dhe aktet nënligjore të planifikimit të nevojshme për zhvillimin e procesit të planifikimit. Po ashtu, planifikimi hyn në agjendën e politikave zhvillimore qendrore dhe lokale duke i falënderuar edhe përkrahjes nga organizatat ndërkombëtare të zhvillimit me programet e tyre të qeverisjes dhe zhvillimit ekonomik lokal. Këto programe kanë kontribuar ekipet komunale të urbanizmit dhe planifikimit t'i përparojnë aftësitë për kryerjen e detyrave të planifikimit dhe menaxhimit urban me njohuritë e marra në trajnimet e organizuara nga këto programe.

Planit Zhvillimor Komunal i Klinës duhet të shërbejë si udhëzues për të:

- Identifikuar lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të territorit të komunës dhe qytetit të Klinës
- Përcaktuar politikat lidhur me vendosjen banimit, zhvillimit rural, zhvillimit të industrisë dhe shërbimeve, turizmit, dhe mbrojtjes së resurseve, trashëgimisë natyrore e kulturore
- Identifikuar rolin e vendbanimeve kryesore dhe veçanërisht Klinës si qendër komunale, në zhvillimin e përgjithshëm ekonomik, social dhe mjedisor të komunës

Klina, si komunë jo e madhe në Kosovë, shquhet me ndryshime pas luftës së vitit 1999. E shkatërruar nga lufta, kjo komunë ka kaluar nga faza e rikonstruktimit në fazën e zhvillimit. Megjithëse Klina ka resurse të konsiderueshme natyrore, pjesa më e madhe e tyre nuk është duk u shfrytëzuar në nivel të duhur.

Si mund të zhvillohet bujqësia, cilat janë mundësítë e shfrytëzimit të qëndrueshëm t[ resurseve nëntokësore, a është turizmi një potencial i pasfrytëzuar, a duhet t'i kushtohet edhe më shumë kujdes arsimt, si të përmirësohet niveli dhe cilësia e shërbimeve janë pyetje të cilave Klina, gjatë procesit të hartimit të planit, duhet t'u jep përgjigje për arritjen e një zhvillimi të qëndrueshëm ekonomik, social dhe mjedisor.

Zbatimi i parimeve të artikular në Ligjin për Planifikim Hapësinor do të jetë bazë mbi të cilat hartuesit e këtij projekti së bashku me komunën do të ndërtojnë kornizën e zhvillimit hapësinor të komunës dhe të qytetit të Klinës për pesë vitet e ardhshme. Procesi parashevë përfshirjen e të gjithë aktorëve që mund të kenë ndikim në planifikim, por edhe atyre që mund të ndikohen nga plani. Kjo mundëson që komuna së bashku me qytetarët ta ndjejnë pronësinë mbi procesin dhe planin.

## **ROLI DHE NATYRA E PLANIT**

Plani Zhvillimor Komunal është dokument i cili duhet të promovojë interesat e përbashkëta të banorëve të Klinës, për një zhvillim më të shpejtë ekonomik, me qëllim të përmirësimit të kualitetit të jetës. Ai njëkohësisht duhet t'i kushtojë kujdes edhe mbrojtjes së resurseve, trashëgimisë natyrore dhe kulturore. Me vendimet të cilat do të miratohen, Plani Zhvillimor Komunal duhet të:

- Mundësojë që, përmes një procesi gjithëpërfshirës dhe transparent, të përcaktojë mënyrën e vendosjes së popullsisë, punësimin dhe shfrytëzimin e resurseve natyrore për t'i shërbyer më së miri zhvillimit të qëndrueshëm ekonomik dhe kualitetit më të mirë të jetës.
- Ndikojë në vendimet politike, lidhur me investimet publike në infrastrukturë, për t'i përmirësuar shërbimet ndaj qytetarëve;
- Përkurahë zhvillimin e balancuar në mes të zonave urbane dhe zonave rurale me zhvillim ekonomik më të ulët;
- Identifikojë lokacionet me potencial të zhvillimit hapësinor të qytetit dhe komunës;
- Aaprovojë vendimet lidhur me zonat e industrisë dhe biznesit, banimit, shërbimeve, turizmit dhe trashëgimisë natyrore dhe kulturore;
- Identifikon rolin e zonave kryesore brenda qytetit dhe atyre rurale, në zhvillimin e përgjithshëm socio-ekonomik dhe kulturor të qytetit dhe komunës së Klinës

## **ROLI I PROFILIT KOMUNAL**

Dokumenti i Profilit Komunal të Klinës, vlerësimi i gjendjes ekzistuese në komunën e Klinës, vlerësimi i resurseve dhe kapaciteteve investive, sfidat e identikuara dhe regjistri i çështjeve të ngritura, gjatë konsultimeve publike nga pjesëmarrësit, duhet ti jepin orientim zhvillimit të ardhshëm të komunës.

Profili Komunal i Klinës, përmban në vete të dhëna dhe analiza, të cilat në bashkëpunim me sektorët e ndryshëm, shprehen në formën e hulumtimeve të përbledhura në një raport. Qëllimi i këtij rapporti është paraqitja e gjendjes së zhvillimeve në hapësirë urbane dhe rurale.

## **QEVERISJA, PJESËMARRËSIT DHE ROLET E TYRE**

Qeverisja, si proces i vendimmarrjes dhe implementimit të vendimeve të mara, mbështetet në aktorët formalë dhe joformalë të përfshirë në proces dhe strukturave formale dhe joformale të vendosura për të marrë vendimet dhe zbatuar ato.

Parimet kryesore të planifikimit hapësinor, lidhur me qeverisjen e mirë janë:

- Pjesëmarrja publike;
- Sundimi i ligjit;
- Transparenca;

- Përgjegjësia;
- Konsensusi;
- Barazia dhe gjithëpërfshirja;
- Efikasiteti dhe
- Llogaridhënia

## **PJESËMARRJA PUBLIKE**

Në respektim të parimeve ndërkombëtare të rekomanduara me ligj e posaçërisht të Agjendës 21 dhe Agjendës së UN-HABITAT, procesi tenton të përfshijë një numër sa më të madh të pjesëmarrësve në fazën përgatitore për hartimin e Planit Zhvillimor Komunal, në mënyrë që parimet e gjithëpërfshirjes, transparencës, efikasitetit, barazisë dhe qëndrueshmërisë të promovohen dhe zbatohen në praktikë nga Komuna e Klinës.

Në bazë të Ligjit për planifikim hapësinor, Plani Zhvillimor Komunal është plan multisektoral, i cili merr parasysh zhvillimet e sektorëve të cilat i menaxhon Komuna e Klinës.

Involvimi i të gjithë pjesëmarrësve, të cilët mund të kenë ndikim ose të janë të ndikuar nga plani është esencial për të zbatuar parimet e pjesëmarrjes publike dhe transparencës së procesit të hartimit të Planit Zhvillimor Komunal.

## **ROLET – VENDIMMARRËSE / JO-VENDIMMARRËSE**

Përveç qeverisë komunale, pjesëmarrësit në proces janë të ndarë sipas rolit dhe detyrës, në pjesëmarrës nga nivelet vendimmarrëse, shoqëria civile dhe sektori privat.

Pjesëmarrësit nga niveli qendror, përfaqësues të ministrive të Qeverisë së Kosovës – MMPH, MEF, MTI dhe MEM, me të dhënat, raportet dhe strategjitë e sektorëve përkatës e plotësojnë përbajtjen e profilit.

Një pjesë e konsiderueshme e të dhënave rrjedhin nga sektori joqeveritar, analizat dhe raportet e të cilëve në të shumtën e rasteve kanë shërbyer për krahasim, e në disa raste edhe si të vetmet burime të të dhënave.

Involvimi i shoqërisë civile përmes procesit të konsultimeve, pjesëmarrjes aktive në hulumtimin e çështjeve dhe hartimin e zgjidhjeve do të rrisë transparencën.

Me sektorin privat do të duhej diskutuar mundësitetë investuese të biznesit lokal, si dhe format e partneritetit publik-privat për realizimin e programeve të ndryshme.

Një rëndësi e veçantë i kushtohet edhe partnerëve ndërkombëtarë, duke filluar prej zyrave ndërlidhëse dhe agjencive zhvillimore ndërkombëtare të cilat kanë programe të zhvillimit në rajon.



## 2.0 PROFILI I SITUATËS KOMUNALE

### KOMUNA E KLINËS NË KOSOVË DHE RAJON

Komuna e Klinës, e themeluar në vitin 1954, shtrihet në anën perëndimore të Kosovës, përkatësisht në pjesën verilindore të Rrafshit të Dukagjinit, në një hapësirë të pasur me potenciale natyrore dhe me lidhje të mira të qarkullimit. Kufizohet me shtatë komuna - në veri kufizohet me Istogun, në lindje me Skenderajn dhe Drenasin, në jug me Malishevën, Rahovecin dhe Gjakovën, ndërsa në perëndim me Pejën.


Territori i Komunës së Klinës shquhet për pasuri natyrore. Hapësira karakterizohet me pyje dhe tokë kualitative bujqësore, pasuri nëntokësore, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore. Nëpër Klinë kalojnë pesë lumenj: Drini i Bardhë, Lumbardhi i Pejës, Klina, Mirusha dhe Lumi i Istogut. Prej tyre katër kanë rrjedhë fushore dhe me ndërtimin e ujënxënjeve do të mund të ujiteshin deri në 2.000 ha toka bujqësore. Pozita gjeografike dhe kushtet klimatike janë të volitshme për zhvillimin e bujqësisë: kultivimi të kulturave bujqësore, perimeve, pemëve si dhe zhvillimin e blegtorisë, shpezëtarisë dhe bletarisë.



Harta 1. Pozita e Klinës në Kosovë dhe rajon

Edhe pse territori i Klinës dhe i tërë Dukagjini përbën një pjesë të mbyllur më vete dhe të rrethuar me male, prapë se prapë kushtet e volitshme natyrore mundësojnë të ketë lidhje të mira të qarkullimit. Rol të rëndësishëm në pozitën e Klinës luan edhe përshkruarja e lumbrit Drini i Bardhë, i cili lidhë Kosovën me Republikën e Shqipërisë ndërsa Llapusha e lidhë këtë territor me Prishtinën dhe më gjerë. Pozita natyrore dhe konfiguracioni mundësojnë që Klina të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhere me rajonin e gjerë. Nëpër Klinë kalon rruga magjistrale Prishtinë - Pejë (dukë përfshirë edhe kryqëzimin për Gjakovë), rruga regionale Klinë - Skenderaj - Mitrovicë dhe rruga regionale Klinë - Istog - Pejë. Nëpër komunën e Klinës kalojnë edhe vijat hekurudhere Fushë Kosovë - Klinë - Pejë dhe Fushë Kosovë - Klinë – Prizren. Lidhjet rrugore dhe hekurudhere që kalojnë nëpër territorin e Klinës, përveç që e lidhin Klinën me qendrat tjera në Kosovë, mundësojnë edhe lidhje të mëtejme me qendrat në rajon, duke qenë një potencial i rëndësishëm

Harta 2. Pozita e Klinës ne kontekst rajonal



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës 2005 - 2015

## ZHVILLIMI HISTORIK

Pozita gjeografike, kushtet e përshtatshme për ekzistencë, pasuritë natyrore dhe klima e favorshme kanë kushtëzuar që treva e Komunës së Klinës të jetë e banuar që nga lashtësia dhe të kriohen vendbanime të shumta, nga banorët vendas.

Vendbanimet në lokalitetin e Klinës datojnë që nga parahistoria - koha e neolitit. Dëshmi përkëtë janë gërmadhat e shumta që gjenden në lokalitete të ndryshme të komunës. Më karakteristike janë gjurmët e lokaliteteve te njohura ilire si ne Përcetë (Përcevë), Qëndresë (Gllarevë), pastaj gërmadhat ende të pahulumtuara ne vetë lokalitetin e Klinës, Dërsnikut, Lugut (Dollcit), Gurgatit (Pograxhës), Klinafcit, Bardhajve (Jashanicës) e shumë të tjera. Janë bërë edhe zbulime të tjera arkeologjike të periudhave të ndryshme historike edhe në vendbanimet tjera. Janë zbuluar sidomos tuma ilire në shumë vendbanime të kësaj komune. Pothuajse në çdo lokalitet të vendbanimeve të sotme ka gjurmë të lokaliteteve të vjetra të periudhave të ndryshme. Janë gjetur edhe gjurmë të shumta të kulturës materiale.

Klina na del si vendbanim i hershëm ilir, me emër Chinna, të cilën e hasim te Ptolemeu që në vitet 87-150 (në hartën e Ptolemeut). Ky lokalitet i lashtë ilir shtrihet në bregun e majtë të rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë, që i përgjigjet realitetit të sotëm gjeografik. Chinna në kuptimin Cin shpjegohet si "kin" në mes të Drinit të Bardhë dhe lumenit Klina.

Në shekullin e parë para erës sonë, romakët filluan depërtimin e tyre pushtues ndërsa më vonë Mbretërisë Dardane iu njoh statusi i provincës së Dardanisë. Gjatë sundimit romak u ngritën shumë vendbanime përgjatë rrugëve kryesore rajonale. Vendbanimet i ngriti një pjesë e popullsisë që zbriti nga vendbanimet e vjetra në kështjellat në kodrina.

Në shekullin e parë të erës sonë, si qendër municipale e fisit dardan përmendet edhe Dërsniku, ndërsa gjatë sundimit bizantin hasim në gjurmët e kishës së Pashkaj (Paskalices) me kambanore në fshatin Videjë.

Kronisti Konstantin Porfirojeni në traktatin e tij të njohur "Shënimë për popujt" në vitin 948-952, shkruan se ndër qytetet e banuar dendur është edhe Dërsniku -"Desstnik". Vendbanim i hershëm është edhe Dollci i sotëm, i cili është i shënuar me emrin Zalug ne hartën e Manastirit të Hilandarit ne vitin 1198/9.

Pushtimi romak shkaktoi pasoja jo vetëm nga aspekti politik, por edhe ekonomik. Në këtë drejtim pësuan vendbanimet, posaçërisht ato të fortifikuara, që ishin të njohura në atë kohë, si dhe fortifikatat mbrojtëse të popullatës iliro-dardane. Pas sundimit romak, bizantin dhe bullgar, trevat Kosovë nga fundi i shekullit XII u pushtuan nga rasianet.

Me ardhjen e sllavëve, edhe në keto treva ndryshoi harta onomastike e saj. Shumë emërtime të vjetra iliro-shqiptare të vendbanimeve, të personave e të tjera u zëvendesuan me emërtime të reja sllave. Në këtë periudhënd e sundimit mesjetar serb, u bë edhe përvetësimi i kishave ekzistuese të asaj kohe.

Në Betejën e Kosovës më 1389, këto treva ranë përkohësisht nën sundimin osman, mirëpo ai nuk e ndryshoi në thelb fisionominë e strukturës etno-kulturore të nacionalitetit shqiptar në Kosovë dhe në Rrafshin e Dukagjinit, megjithatë, solli ndryshime të rëndësishme në planin politik, ekonomik, shoqëror e ideologjik. Defteret osmane, shënimet e udhëpërshkruesve të ndryshëm gjatë sundimit osman e burime të tjera japid shëname të rëndësishme, përtrevat shqiptare duke përfshirë edhe territorin e Klinës ne veçanti. Të bazuar në defterin e Vilajetit Vëllk të vitit 1455, qendër e kësaj treve ishte Dollci, si nahi, me manastirin e tij dhe me 19 fshatra te tij. Vendbanimi më i madh ishte Dërsniku me 104 shtëpi. Edhe Vushtrria e sotme me shumë vendbane ishte në kuadër te kësaj Nahije.

Gjatë sundimit osman edhe në këto treva ndodhen shumë luftëra, kryengritje, rezistencë e popullatës shqiptare, dhe sigurisht që kishte lëvizje të shumta të popullsisë. Të gjitha këto u reflektuan edhe në krijimin, rrënimin, ngritjen etj. të vendbanimeve të këtij territori.

Pas rënies së Perandorisë Osmane më 1912, Kosova u pushtua nga Serbia dhe Mali i zi dhe më tutje gjatë shekullit XX, kaloi nëpër një varg të krisave, luftërave e pushtimeve të ndryshme. Këto ndryshime lanë pasoja tejet të rënda në zhvillimin e përgjithshëm shoqëror, ekonomik dhe politik. Nga kjo situatë nuk u kursye as treva e Klinës. Format e ndryshme të presioneve sociale, politike e ekonomike vazhduan gjatë tërë kësaj periudhe ndërsa pati momente kur u rrezikua edhe vetë ekzistenca fizike e popullatës.

Burimi: Dr. Jusuf Osmani, Vendbanimet e Kosovës - Klina  
M. Carabregu, Geo hartografia  
Dr. Zef Mirdita, Studime dardane, Rilindja, Prishtinë 1979  
Kuvendi Komunal i Klinës, Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal të Klinës 2003  
Mr. Asllan Krasniqi, Klina me rrëthinë në valën e historisë. Klina, 2002  
Oblast Brankovica, Opsirni katastarski popis iz 1455 godine, Sarajevo, 1972

## ZHVILLIMI INSTITUCIONAL

### ADMINISTRIMI TERRITORIAL NË KOMUNËN E KLINËS

Komuna e Klinës përfshinë një sipërfaqe prej 308.8 kilometra katrore. Administrohet nga 9 zyra vendore dhe ka 54 vendbanime. Qyteti i Klinës ka pozitë qendrore në kontekst të komunës dhe paraqet nyje një të rëndësishme të qarkullimit. Përveç Klinës, si qendër komunale, në kuadër të komunës përfshihen edhe këto vendbanime: Berkovë, Binxhë, Bokshi, Budisalc, Çabiq, Caravik, Deiq, Dobërdol, Dollc, Dollovë, Dranashi, Drenoc, Dresnik, Dugajevë, Dush, Dush i Vogël, Gjurgjevik i Madh, Gjurgjevik i Vogël, Gllarevë, Grabanicë, Grabc, Gremnik, Jagodë, Jashanicë, Jellok, Kërrnicë, Klinafc, Këpuz, Krushevë e Madhe, Krushevë e Vogël, Leskoc, Nagllavë, Përçevë, Pjetërq i Epërm, Pjetërq i Poshtëm, Pograxhë, Qeskovë, Qupevë, Radulloc, Ranoc, Resnik, Rixhevë, Rudicë, Sferkë, Shtupel, Siqevë, Stupë, Ujmirë, Videjë, Volljakë, Zabërgjë, Zajm dhe Zllakuqan.

Harta 3. Ndarja administrative e Komunës së Klinës.




Tabela 1. Grupimi i vendbanimeve sipas zyreve të vendit

ZYRA E VENDIT	VENDBANIMI	ZYRA E VENDIT	VENDBANIMI
I. KLINË	1. Klinë	V. JASHANICË	1. Jashanicë
	2. Dollc		2. Pograxhë
	3. Dërsnik		3. Resnik
	4. Gremnik		4. Jelloc
	5. Zajm		5. Dush
	6. Videjë		6. Gurgjevik i Madh
	7. Deiq	VI. UJMIRË	1. Ujmirë
	8. Krushevë e Vogël		2. Çabiq
	9. Gjurgjevik i Vogël		3. Siqevë
	10. Klinafc		4. Dobërdol
	11. Jagodë	VII. GLLAREVË	1. Gllarevë
II. BUDISALC	1. Budisalc		2. Rixhevë
	2. Rudicë		3. Carravik
	3. Krushevë e Madhe		4. Zabërgjë
	4. Stupë	VIII. SFERKË	1. Sferkë
	5. Nagllavë		2. Dush
III. ZLLAKUQAN	1. Zllakuqan		3. Volljakë
	2. Ranoc		4. Qypevë
	3. Leskoc		5. Përqevë
	4. Radulloc	IX. SHTUPEL	1. Shtupel
	5. Berkovë		2. Kërnicë
IV. DRENOC	1. Drenoc		3. Bingjë
	2. Grabanicë		4. Gapç
	3. Dugajevë		5. Dranashiq
	4. Pjetërq i Poshtëm		
	5. Pjetërq i Epërm		
	6. Bokshiq		
	7. Dollovë		
	8. Këpuz		
	9. Qeskovë		

## QEVERISJA LOKALE

Duke u mbështetur në mandatin e dhënë Komunave të Kosovës nga Ligji për Vetëqeverisjen Lokale , Kuvendi i Komunës së Klinës në vitin 2010, nxori dhe miratoi Statutin e Komunës së Klinës. Në bazë të statutit, organet komunale janë:


1. Kuvendi i Komunës, si organi më i lartë përfaqësues, legjislativ dhe vendimmarrës i Komunës,
2. Kryetari i Komunës, si organi më i lartë Ekzekutiv i Komunës.

Kuvendi Komunal i Klinës, në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale, përbëhet prej 27 përfaqësuesve.

Pjesa ekzekutive e qeverisjes përbëhet prej kryetarit, nënkyetarit dhe dhjetë drejtorive komunale.

Burimi: Statuti i Komunës së Klinës

Skema 1 . Organogrami i qeverisjes lokale të Klinës





## ZHVILLIMI SOCIAL

### DEMOGRAFIA

#### GJENDJA FUSHËN E TË DHËNAVE DEMOGRAFIKE

Regjistrimi i fundit i përgjithshëm valid në Kosovë është bërë në vitin 1981 nga Enti i Statistikor i Kosovës. Në vitin 1991 është bërë edhe një regjistrim i përgjithshëm në Kosovë mirëpo të dhënat nga ky regjistrim duhet të merren me rezervë pasi që ai u bojkotua nga populli shqiptar. Në këtë gjendje të të dhënave statistikore është vështirë të jepen vlerësimet e sakta për numri dhe strukturën e popullsisë në Kosovë.

Mungesa e të dhënave valide statistikore në Kosovë bëhet sidomos e ndjeshme pas lëvizjeve të mëdha të popullatës gjatë viteve nëntëdhjetë, si dhe gjatë dhe pas luftës. Pas çlirimt, organizatat dhe institucionet ndërkombëtare dhe vendore filluan të plotësojnë mungesën e të dhënave, përmes hulumtimeve dhe anketimeve të ndryshme. Duke qenë se në këtë proces janë përrfshirë organizata të ndryshme, nuk është arritur ndonjë standard konsistent i metodologjisë apo i cilësisë. Këto të dhëna e mbledhura nga organizatat ndërkombëtare, si dhe ato nga ESK mund të vlerësohen si pjesërisht të besueshme. Vlerësimet momentale janë se në Kosovë jetojnë rreth 2 milion banorë.

Situata nuk ndryshon shumë edhe për sa i përket të dhënave demografike për komunën e Klinës. Informatat për ndryshimet demografike pas vitit 1981 janë tejet të pakta dhe pjesërisht të besueshme. Këtu duhet pasur parasysh se vlerësimet deri në vitin 1981 kanë të bëjnë më kufijt e vjetër komunal të Klinës, para krijimit të komunës së Malishevës. Me krijimin e kësaj komune të re në vitin 1986, territori komunal i Klinës zvogëlohet nga  $403\text{km}^2$  në  $308.8\text{km}^2$ . Ky fakt e bën më të vështirë krahasimin e nevojshëm të të dhënave demografike me periudhën para vitit 1981 si dhe projekzionet për të ardhmen. Si do që të jetë, informatat para vitit 1981 mund të na shërbejnë si një pasqyrë e përafert e lëvizjeve demografike brenda Komunës së Klinës. Këto të dhëna dhe vlerësimet janë plotësuar edhe me të dhënat e mbledhura dhe të sistemuara për nevojat hartimit të Planit Zhvillimor Urban të Klinës.

#### LËVIZJA E NUMRIT TË PËRGJITHSHËM TË BANORËVE

Kur flasim për ndryshimin e numrit të banorëve në Komunën e Klinës gjatë viteve të regjistrimit, periudhën 1948-1981 e trajtojmë si të veçantë për dy arsyet:

- kjo periudhë është e mbuluar me regjistrime valide
- regjistrimet përfshinë komunën e Klinës në kufijt para vitit 1986

Prej vitit 1948 deri në vitin 1981 numri i banorëve të Komunës së Klinës u rrit nga 26090 në 54449 përkatësist u shtua për 28359 banorë. Shkalla e shtimit gjatë kësaj periudhe ishte 2.3% ndërsa indeksi i shtimit ishte 208.7, vlera këto që janë më të vogla se vlerat përkatëse për Kosovën. Gjatë kësaj periudhe shtimi i përgjithshëm i popullsisë në komunë ishte më i vogël se shtimi natyror si pasojë e migrimeve të popullsisë nga ky rajon.

Tabela 2. Numri i banorëve sipas viteve – periudha 1948-1981

	<b>Komuna e Klinës</b>		<b>Kosova</b>	
Viti	nr. i banorëve	ban. të shtuar gjatë periudh. paraprake	nr. i banorëve	ban. të shtuar gjatë periudh. paraprake
1948	26090		729000	
1953	28333	2243	808000	79000
1961	33946	5613	964000	156000
1971	42351	8405	1244000	280000
1981	54449	12098	1584000	340000

Burimi për Klinë: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

Burimi për Kosovë: Kosovo and its population – MSHP, 2003

Tabela 3. shtimi i numrit të përgjithshëm të banorëve midis periudhave 1948-1981

	<b>Komuna e Klinës</b>		<b>Kosova</b>	
periudha	indeksi	shkalla	indeksi	shkalla
1948-1953	108.6	1.7	111.3	2.2
1953-1961	119.8	2.2	118.1	2.1
1961-1971	124.8	2.2	129	2.6
1971-1981	128.6	2.5	127.4	2.5
1948-1981	208.7	2.3	217.28	2.6

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke –EUP, Prishtinë 1984

Për shqyrtimin e ndryshimeve demografike pas vitit 1981, duke pasur parasysh territorin komunal të Klinës në kufijt pas vitit 1986 ( $308.8\text{km}^2$ ), bazohemi në vlerësimet e disa burimeve – Entit Statistikor të Kosovës, OSBE-së dhe drejtoreve komunale. Sipas këtyre vlerësimeve, ndryshimet demografike gjatë kësaj periudhe duken si vijon:

Tabela 4. Numri i banorëve sipas viteve – periudha 1981-2003 (kufijt komunalë pas vitit 1986)

	<b>Komuna e Klinës</b>		<b>Kosova</b>	
Viti	nr. i banorëve	ban. të shtuar gjatë periudh. paraprake	nr. i banorëve	ban. të shtuar gjatë periudh. paraprake
1981	42813		1584000	
1991	52266	9453	1956196	372196
2003	~ 55000	~ 2734	~ 2462786	~ 506590

Burimi: vitet 1981, 1991 – ESK

viti 2003, Klina – Drejtoria Komunale për Ekonomi Zhvillim e Rindërtim

viti 2003, Kosova - OSBE


Tabela 5. Shtimi i numrit të përgjithshëm të banorëve midis periudhave 1981-2003

	<b>Komuna e Klinës</b>		<b>Kosova</b>	
periudha	indeksi	shkalla	indeksi	shkalla
1981-1991	122.1	2.0	123.5	2.1
1991-2003	~ 105.2	~ 0.42	~ 125.9	~ 1.95
1981-2003	~ 128.5	~ 1.2	~ 155.5	~ 2.1


Ndërsa sipas të dhënavëve paraprake nga regjistrimi I fundit (2011)nga ESK komuna e Klinë ka 38200 banorë, ku 11200 jetojën në diasporë.

Gjatë kësaj periudhe numri i banorëve në Komunën e Klinës u shtua për rreth 12187 banorë. Indeksi i shtimit prej ~105.2 dhe shkalla e shtimit prej ~0.42% gjatë periudhës 1991-2003 janë dukshëm më të ulëta se vlerat përkatëse për periudhat e mëhershme. Këto të dhëna pasqyrojnë ndikimin negativ të krizës së viteve '90 dhe luftës së fundit në shtimin e përgjithshëm të numrit të banorëve në Komunën e Klinës.

Diagrami 1. Shtimi numrit të të banorëve 1948 - 2003



Diagrami.2 Indeksi i shtimit të banorëve 1948 - 2003




## DENDËSIA E POPULLSISË


Komuna e Klinës, karakterizohet me një dendësi të lartë të popullsisë me trend të rritjes së mëtutjeshme, ngjashëm me trendin e përgjithshëm në Kosovë. Në periudhën 1948-1961 dendësia e popullsisë ishte e përafërt me mesataren e Kosovës ndërsa në periudhat pasuese rritja e dendësisë ishte diçka më e ulët se kjo mesatare. Gjatë periudhës 1961-1991 rritja e dendësisë ishte rreth 1.2 herë përdhjetëveçar derisa pas viti 1991 kjo rritje vazhdon por me një ritëm më të ulët. Në vitin 2003, sipas vlerësimeve, dendësia në Komunën e Klinës kishte rreth 178.1 banorë / km<sup>2</sup> që është më e ulët se mesatarja e Kosovës për rreth 48 banorë / km<sup>2</sup>.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke –EUP, Prishtinë 1984  
OSBE  
Komunale e Klinës

Diagrami.3. Dendësia e popullsisë 1948 - 2003



## Harta 4. Klasifikimi i komunave të Kosovës në bazë të dendësisë së popullsisë



Burimi: Profili i Kosoves – IPH, MMPh 2004

## SHTIMI NATYROR

Shkalla e natalitetit në Komunën e Klinës përgjatë viteve, ka qenë e lartë por me një rënie të vazhdueshme. Në vitin 1960 shkalla e natalitetit në komunë ishte 49‰ ndërsa në vitin 1978 u zvogëluar në 39.7‰. Mesatarja e Kosovës për këto dy vite ishte 41.1‰ më 1960 dhe 32.1‰ më 1978.

Në këtë periudhë të njëjtë edhe shkalla e mortalitetit pati një zvogëlim i cili ishte si rezultat i arsimimit më të madh shëndetësor, zhvillimit të shërbimeve shëndetësore dhe përmirësimit të kushteve jetësore. Në vitin 1960 shkalla e mortalitetit ishte 16.7‰ ndërsa në vitin 1978 kjo shkallë bie në 6.6‰. Në zvogëlimin e shkallës së përgjithshme të mortalitetit ndikoi edhe zvogëlimi i shkallës së vdekshmërisë së foshnjave gjatë kësaj periudhe.

Përkundër zvogëlimit të natalitetit dhe mortalitetit, shkalla e shtimit natyror mbeti e lartë dhe gjatë periudhës 1961 – 1971 kishte vlerën prej 31.0‰ në vit.

Edhe pse pothuajse të gjithë treguesit e shtimit të popullatës kanë shënuar rënie gjatë viteve të fundit, popullata e Kosovës ende mbetet njëra ndër popullatat me shtim më të lartë jo vetëm në rajon por edhe më gjerë. Ky është rezultat i zvogëlimit të ngadalshëm të shkallës së natalitetit dhe i zvogëlimit rapid të shkallës së mortalitetit. Shkalla e shtimit natyror është rrëth 13 % në vit.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke –EUP, Prishtinë 1984  
Profili i Kosovës – MMPH

## LËVIZJA MEKANIKE E POPULLSISË – MIGRIMET

Ndryshimet e numrit të popullsise së Klinës përgjatë periudhave janë edhe si pasojë e migrimeve.

Të dhënat e vitit 1971 për karakteristikat e migrimeve në Komunën e Klinës tregojnë se më tepër se çereku i banorëve të regjistruar atë vit kategorizoheshin si të ardhur. Nga 42351 banorë të Komunës së Klinës (regjistrimi 1971), 11382 banorë apo 26.9% ishin të ardhur nga ndonjë vendbanim tjeter. Nga ky numër 45.4% kishin ndërruar vendbanimin brenda vetë komunës ndërsa pjesa tjeter prej 54.6% ishin të ardhur nga ndonjë komunë tjeter e sh Jugosllavisë (informata për ardhjen nga komunat brenda Kosovës mungon).

Informata për periudhat e mëvonshme që kanë të bëjnë me migrimet e popullsise janë të pakta. Nga numri i sotëm i banorëve të komunës i cili vlerësohet të jetë rrëth 55000, 10274 (18.7%) jetojnë në botën e jashtme.

Qyteti i Klinës si qendër komunale është karakterizuar me migrim të popullatës në te. Sipas të dhënavë nga hulumtimi në terren 61.5% të familjeve jetojnë në këtë qytet para vitit 1990, 6% të familjeve janë vendosur në Klinë gjatë periudhës 1990-1999, ndërsa pas luftës së vitit 1999 në Klinë janë vendosur 32.6% të familjeve. Si arsyë kryesore për migrim në Klinë janë cekur arsyet sociale, puna, shkollimi dhe infrastruktura.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke –EUP, Prishtinë 1984  
Drejtoria Komunale për Ekonomi Zhvillim e Rindërtim

## STRUKTURA E POPULLSISË

Struktura gjinore - Komuna e Klinës karakterizohet me pjesëmarrje më të madhe të meshkujve në numrin e përgjithshëm të popullatës. Me këtë veçori, Klinë nuk paraqet ndonjë përjashtim nga trendet e përgjithshme në nivel të Kosovës ndërsa përqindja e meshkujve është diçka më e madhe se mesatarja e Kosovës.

Sa i përket jetëgjatësisë sipas gjinive, femrat jetojnë mesatarisht 2.10 vjet më gjatë se meshkujt (meshkujt 67.03, femrat 69.13 vjet mesatarisht). Jetëgjatësia është i vetmi kriterium sipas të cilët femrat janë në epërsi ndaj meshkujve. Nëse shikohen të dhënat mesatare të zhvillimit social, sidomos të punësimit dhe të ardhurave, femrat janë në një disavantazh të theksuar ndaj meshkujve.

Në qytetin e Klinës struktura sipas gjinisë është më e barazpeshuar në krahasim me pjesën tjetër të komunës. Sipas hulumtimit në terren, numri i meshkujve dhe femrave është pothuajse i barabartë, me një dominim të vogël të femrave prej 0.5%.

Tabela 6. Struktura gjinore e popullsisë së Komunës së Klinës sipas viteve

vitet e regjistrimit	gjithsej banorë	meshkuj numri	%	femra numri	%
1971	42351	21974	51.9	20377	48.1
1981	54539	28658	52.6	25881	47.4
2003	55000	28545	54.9	26455	48.1

vërejtje: të dhënat për vitet 1971, 1981 përfshijnë Kom. e Klinës në kufijt para vitit 1986

Burimi: Vitet 1971, 1981 – ESK

Viti 2003 – Drejtoria Komunale për Ekonomi, Zhvillim e Rindërtim

Tabela 7. Dallimet në mes gjinive sipas disa kriteriumeve të cilësisë jetësore dhe zhvillimit social


	jetëgjatësia		arsimimi tek te rriturit %		mes. e viteve të shkollimit		pjesëm. në fuq.punëtore%		të ardhurat mujore €	
	m	f	m	f	m	f	m	f	m	f
Kom. e Klinës	67.03	69.13	97.54	91.47	9.81	7.78	72.33	34.59	104.82	21.26
Kosova	67.82	69.97	97.28	91.32	10.4	8.42	75.42	30.91	135.92	42.23

Burimi: Raport i Zhvillimit Njerëzor – UNDP, 2004

Diagrami 4. Pjesëmarrja në fuqinë punëtore sipas gjinisë



Diagrami 5. Mesatarja e të ardhurave mujore sipas gjinisë (2004)



## STRUKTURA SIPAS MOSHËS

Popullsia e Komunës së Klinës është karakterizuar me pjesëmarrje të theksuar të popullatës së re, ngjajshëm me trendet e përgjithshme në Kosovë. Si rezultat i natalitetit të lartë dhe përmirësimit të kushteve të jetesës, në vitin 1981 popullata e moshës 0-24 vjet përbente 62.4% të popullsisë së përgjithshme të komunës.

**Tabela 8.** Struktura e popullsisë së Komunës së Klinës sipas moshës

	0-9 vjet		10-24 vjet		25-64 vjet		65+ vjet	
	numri	%	numri	%	numri	%	numri	%
1971	14956	32.1	8106	17.4	20613	44.2	2919	6.3
1981	17793	32.4	17540	32.0	16655	30.4	2872	5.2

Burimi: 1971- Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke –EUP, Prishtinë 1984  
1981 - ESK

Informatat dhe vlerësimet për strukturën e tanishme sipas të popullsisë moshës, janë të pakta. Vlerësohet se 53% e popullsisë së tërësishmë të komunës përbëhet nga banorët e moshës deri në 25 vjet.

Burimi: Strategjia e Zhvillimit Ekonomik Lokal 2003-2006 – RIINVEST

## ZHVILLIMI SOCIAL SIPAS SEKTORËVE

Zhvillimi njerëzor është proces i vazhdueshëm i cili varet nga tre faktorë themelor që ndryshojnë në proporcione me ndryshimin e nevojave njerëzore, nga të cilat më thelbësore janë shëndetësia-jeta e gjatë dhe e shëndoshë, arsimimi-marrja e njohurive dhe aftësive dhe qasja në burimet private dhe publike të nevojshme për jetë normale.

### ARSIMI

Parimi kryesor i politikës së arsimit sot në Kosovë është “arsim gjithëpërfshirës”, sipas të cilit të gjithë fëmijët dhe të rinjtë në Kosovë duhet të kenë mundësi të vijojnë shkollimin. Që nga viti 2000 ka filluar të aplikohet sistemi i ri i arsimit i klasifikuar sipas ISCED 9719 (Klasifikimi standard ndërkombëtar i arsimit), brenda të cilit ka 6 nivele të arsimit.

Trendet e përgjithshme në Kosovë tregojnë shenja të përmirësimit, së paku sa i përket regjistrimit në shkolla filllore dhe eliminimit të analfabetizëm. Niveli i analfabetizmit në Kosovë është i ngjashëm me atë në Maqedoni, por është më i ultë se në Shqipëri apo në Bosnjë e Hercegovinë. Kosova sa i përket shkollimit ka më shumë gjëra të përafërtë me vendet e zhvillimit të lartë njerëzor se sa me ato të zhvillimit të ultë njerëzorë.

Sa i përket zhvillimit të arsimit në Komunën e Klinës, mund të bëhen krahasime me dokumentet e mëhershme. Të dhënat nga Plani Hapësinor i Prekorupës (1985) tregojnë se në vitin 1961 pjesëmarrja e analfabetëve ka qenë 46.6 %. Kjo përqindje në ndërkokë sipas hulumtimeve në vitin 1971 zvogëlohet në 10.6 %. Në numrin e përgjithshëm të analfabetëve në vitit 1961 pjesëmarrja e femrave prezantohet me një përqindje më të madhe prej 64.2 % deri sa për territorin e Kosovës kjo përqindje ishte 66.7%. Ndërsa, vetëm në komunën e Klinës në numrin e përgjithshëm të analfabetëve përqindja e femrave ishte 63.2 % e cila në vitet 1971 zvogëlohet në 45.3 %. (Subregjioni i Prekorupës në atë kohë përfshinte këto vendbanime – Klinë, Rahovec, Istog, Suharekë)

Sipas të dhënave nga viti 2004, përqindja e të pa arsimtarëve të mbi moshës 15 vjeçare në komunën e Klinës prezanton me 0.55 % deri sa në Kosovë kjo përqindje është 0.96 % .

Tabela 9. Përqindja arsimimit të njerëzve 15 vjeçar e përbimi – krahasimi i Klinës me Pejët dhe Kosovën

	P arsimim a	Më pak se shkollë fillore (1-3vite)	Më pak se shkollë filllore (4-7 vite)	Shkollë fillore	Më pak se shkollë të mesme (9-10 vite)	Shkollë të mesme (11-12)	Shkollë të Lartë	Universitet e më lartë	Gjithsejtë
Pejë	0.59	1.52	10.44	26.02	7.33	40.22	13.14	0.73	100
Klinë	<b>0.55</b>	<b>2.03</b>	<b>15.29</b>	<b>34.07</b>	<b>8.66</b>	<b>31.86</b>	<b>6.63</b>	<b>0.92</b>	<b>100</b>
Kosovë	0.96	2.07	11.37	29.34	7.10	39.30	8.22	1.65	100
Rural	0.97	2.25	12.98	33.70	7.20	36.04	5.91	0.94	100
Urban	0.95	1.88	9.46	24.14	7.01	43.15	10.94	2.47	100
Mashuj	0.57	1.60	7.52	20.77	8.00	48.21	10.99	2.33	100
Femra	1.35	2.57	15.25	37.95	6.22	30.31	5.42	0.94	100

Tabela 10. Shkalla e arsimimit, shkalla e regjistrimit dhe mesatarja e viteve të shkollimit sipas gjinisë

	Shkalla e regjistrimit %									
	Shkalla e arsimimit		Fillor		Të mesëm				Mesatarja e viteve të shkollimit	
	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra	Meshkuj	Femra
Pejë	98.19	92.88	94.83	95.36	85.25	74.03	90.91	88.16	10.89	9.07
Klinë	<b>97.54</b>	<b>91.47</b>	<b>96.51</b>	<b>97.37</b>	<b>71.79</b>	<b>50.00</b>	<b>88.80</b>	<b>78.86</b>	<b>9.81</b>	<b>7.78</b>
Totali	97.28	91.32	94.92	96.00	78.76	71.53	89.50	87.41	10.40	8.42
Rural	97.03	90.97	95.61	95.94	75.24	66.13	88.71	85.69	10.00	7.94
Urban	97.54	91.74	94.03	95.98	83.38	78.39	90.54	89.70	10.88	8.99

Burimi: Raporti i Zhvillimit Njerëzor – UNDP, 2004.; Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë ; Profili i Kosovës - MMPH

Procesi edukativo-arsimor në komunën e Klinës zhvillohet në tre nivele: arsimin parashkollar, fillor dhe të mesëm. Në kuadër të këtij sistemi funksionojnë 15 institucionë të shkollimit fillor (15 shkolla amë dhe 12 paralele të ndara), 2 shkolla të mesme dhe një çerdhe e fëmijëve.

Sipas të dhënave nga Drejtoria për Arsim, numri i përgjithshëm i nxënësve të regjistruar në vitin shkollor 2010/2011 është 10318 (4957 femra dhe 5361 meshkuj), të ndarë në 420 paralele. Numri i përgjithshëm i punëtorëve në institucionet arsimore është 656, prej të cilëve 546 janë mësimdhënës. Nga këto të dhëna del se raporti nxënës/mësimdhënës është përafërsisht 19/1.

Në kuadër të nivelit parashkollar, i vetmi institucion në komunë është "Xhevë Lladrovci", që funksionon në Klinë. Kërkesat për regjistrimin e fëmijëve janë shumë më të mëdha në raport me kapacitetet, ndërsa momentalisti është 656, prej të cilëve 546 janë mësimdhënës. Në këtë çerdhe gjithsej janë të punësuar 10 punëtorë, prej të cilëve 4 janë edukatore.

Në arsimin fillor gjatë viti shkollor 2010/2011 janë regjistruar 8096 nxënës. Krahasuar me vitet paraprake numri i nxënësve është gati se i njëjtë. Në këtë nivel të arsimit janë të angazhuar 437 mësimdhënës. Krahasuar me vitin paraprak numri i kuadrit arsimor është i ngjashëm. Në shumicë

e shkollave mësimi zhvillohet në dy ndërrime.

Foto 1. Shkolla Fillore "Dëshmorët e Qëndrues", Gllarevë



Foto 2. Udhëtimi i nxënësve në këmb[




Arsimi i mesëm në komunën e Klinës zhvillohet në dy institucionë: Gjimnazit "Fehmi Agani" dhe Shkollës së Mesme Teknike Profesionale "Luigj Gurakuqi". Duke qenë se këto dy institucionë janë të vetmet të nivelit të mesëm në komunë, në to gravorojnë nxënës nga tërë komuna. Në Gjimnazin "Fehmi Agani" vijojnë gjithsej 1093 nxënës (309 vajza dhe 784 djem) ndërsa SHMTP "Luigj Gurakuqi" vijojnë 1079 nxënës (606 vajza dhe 473 djem). Mësimi zhvillohet në dy ndërrime. Objekti i ri shkollës së mesme është në fazën e ndërtimit, që do të mundësojë funksionimin e dy institacioneve në objekte të veçanta.

Shikuar në përgjithësi, shpërndarja e rrjetit të institacioneve shkollore në komunë është e tillë që ende imponon lëvizje në distanca më të mëdha në disa raste. Ndërkaq, shumica e ndërtimesave shkollore, përvëë klasëve të mësimit, kanë nevojë për investime në hapësiar tjera si kabinete, salla të kulturës fizike, pajisje mësimore etj. Përmirësimi i kushteve mësimore në pjesët rurale është një prej elementeve kryesore që do të stimulonte qëndrimin e banorëve në fshat dhe zhvillimin e zonave rurale.


**Tabela 11.** Numri i nxënësve dhe personelit në institucionet arsimore në komunë - viti shkollor 2010/2011

Nr.	Komuna	Vendi	Emri i shkollës	Shk. Amë/par. E ndarë	Lok. Ishk. Urban / Rural	Nr. I ndrrimeve	Shqip/Serb/ Mësues (shkollat)	Meshkuj	Femra	Gjithsej	Nr. I nxënësve	Mësimdhë nës	Personel	
1	Klinë	Klinë	"Xhevë Lladrovci"	Amë	U	1	Shqip	30	20	50	4	1	5	
<b>Gjithsej institucionale parashkollore</b>														
1	Klinë	Klinë	"Ismet Raci"	Amë	U	2	Shqip	659	69	1358	54	4	1	5
2	Klinë	Gj. I Vogël	"Ismet Raci"	Par. E ndarë	R	1	Shqip	4	3	7				
3	Klinë	Sférnë	"Emin Duraku"	Amë	R	2	Shqip	331	304	635	53	3	6	
4	Klinë	Valljak	"Emin Duraku"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	131	139	270				
5	Klinë	Përçevë	"Emin Duraku"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	102	117	219				
6	Klinë	Klinë	"Motrat Qiriazi"	Amë	U	2	Shqip	362	348	710	45	2	4	
7	Klinë	Zajm	"Motrat Qiriazi"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	114	125	239				
8	Klinë	Grabanicë	"Azem Bejtë"	Amë	R	2	Shqip	202	191	393	32	1	4	
9	Klinë	Këpuz	"Azem Bejtë"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	100	88	188				
10	Klinë	Jashanicë	"Tre Dëshmorët"	Amë	R	2	Shqip	133	131	264	39	2	7	
11	Klinë	J. e Epërmë	"Tre Dëshmorët"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	114	114	228				
12	Klinë	Gjurgevik i Madh	"Tre Dëshmorët"	Par. E ndarë	R	1	Shqip	45	48	93				
13	Klinë	Resnik	"Tre Dëshmorët"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	18	8	26				
14	Klinë	Gillarevë	"Dëshmorët e Qëndre	Amë	R	2	Shqip	292	304	596	28	2	5	
15	Klinë	Ujmirë	"Ali Krasniqi"	Amë	R	2	Shqip	175	176	351	34	2	4	
16	Klinë	Çabiq	"Ali Krasniqi"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	164	154	318				
17	Klinë	Zllakuqan	"Atë Sh. Gjeçovë"	Amë	R	2	Shqip	182	183	365	31	2	5	
18	Klinë	Leskoc	"Atë Sh. Gjeçovë"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	50	36	86				
19	Klinë	Cerovik	"Esad Mekul"	Amë	R	2	Shqip	186	206	392	19	1	2	
20	Klinë	Shtupel	"Avni Zhabota"	Amë	R	2	Shqip	114	82	196	25	2	4	
21	Klinë	Kernicë	"Avni Zhabota"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	61	66	127				
22	Klinë	Drenoc	"Iса Boletini"	Amë	R	1	Shqip	52	86	138	25	1	4	
23	Klinë	Potërq	"Iса Boletini"	Par. E ndarë	R	2	Shqip	67	67	134				
24	Klinë	Gremnik	"Zgjimi"	Amë	R	2	Shqip	160	127	287	17	1	2	
25	Klinë	Siqevë	"Ymer Berisha"	Amë	R	2	Shqip	89	76	165	11	2	2	
26	Klinë	Jagodë	"Atë Gj. Fishta"	Amë	R	2	Shqip	70	63	133	11	1	2	
27	Klinë	Budisalc	"Nënë Tereza"	Amë	R	1	Shqip	97	81	178	13	1	1	
<b>Gjithsej Fillore</b>														
1	Klinë	Klinë	"Luigj Gurakuqi"	Amë	U	2	Shqip	473	606	1079	47	4	9	
2	Klinë	Klinë	"Fehmi Agani"	Amë	U	2	Shqip	784	309	1093	58	1	4	
<b>Gjithsej të mesme :</b>														
<b>Gjithsej :</b>														
								<b>5361</b>	<b>4957</b>	<b>10318</b>	<b>546</b>	<b>32</b>	<b>78</b>	

Harta 5. Rrjeti i ndërtesave arsimore në komunë



Harta 6. Rrjeti i ndërtesave shëndetësore në komunë



## SHËNDETËSIA

Shërbimi shëndetësor publik në Kosovë ndahet në disa nivele: shërbimet parësore që kryhen në Qendrat Kryesore të Mjekësisë Familjare, Qendra të Mjekësisë Familjare edhe Ambulanca; shërbimet dytësore që kryhen në 5 Spitale Rajonale dhe dy spitale tjera në Vushtrri dhe Ferizaj; shërbimi terciar publik për tërë Kosovën ofrohet në Qendrën Klinike Universitare në Prishtinë.

Në komunën e Klinës shërbimi publik primar shëndetësor ofrohet në Qendrën Kryesore të Mjekësisë Familjare (QKMF) në Klinë, në 3 qendra të mjekësisë familjare në fshatrat Zllakuqan, Ujmirë dhe Sverkë, si dhe në 10 ambulanca (punkte shëndetësore) në fshatrat Budisalc, Jagodë, Drenoc, Grabanicë, Volljakë, Gllarevë, Cerovikë, Jashanicë, Jashanicë e Epërme dhe Shtupel.

Qendra Kryesore e Mjekësisë Familjare ‘Nëna Terezë’ paraqet institucionin kryesor shëndetësor në komunë. Në kuadër të këtij institucioni, përpos kujdesit primar shëndetësor, ofrohen edhe shërbimi i ndihmës së shpejtë, praksës së përgjithshme, shërbimi internist, shërbimi i pediatrisë dhe i gjinekologjisë, shërbimi ORL, shërbimi i dispanzerit antituberkular, shërbimi neuropsikiatrik, shërbimi i rëntgenit, shërbimi i vaksinimit, shërbimi i laboratorit, shërbimi i patronazhit, shërbimi stomatologjik.

Përpos shërbimit publik në shëndetësi, në Klinë është prezent edhe praksa private si me poliklinika, ambulanca dhe barnatore.

Shërbimi shëndetësor dytësor më i afërt ofrohet në Spitalin Regional në Pejë.

Faktor i rëndësishëm i cili duhet të merret para shërbim, është numri dhe distanca e institucioneve shëndetësore. Numri i pamjaftueshëm dhe disatancat mund të ndikojnë në lëvizjen e banorëve drejt Klinës, si qendr komunale, duke shkaktuar k[sh]tu një tejngarkim të QKMF në qytet.

Burimi: Hulumtimi në terren; Plani Zhvillimor Urban 2005 - 2015

Foto 3. QMF në Zllakuqan



Foto 4. Ambulanca në Jagodë



## SHËRBIMET ADMINISTRATIVE

Shërbimet administrative kryesore në nivel të komunës janë të përqendruara në Klinë, ku përfshihen shërbimet e Kuvendit Komunal me zyret përkatëse, Qendra për Punë Sociale (në kuadër të Ministrisë për Punë dhe Mirëqenie Sociale), Qendra për Rergjistrim (në kuadër të Ministrisë për Punë të Brendshme), Post-Telekomi, si dhe filialat e disa prej bankave komerciale. Përqendrimi i këtyre shërbimeve në qytetin e Klinës, si dhe i shërbimeve tjera - shkollimi dhe shëndtësia me qasje të lehtë, infrastruktura etj. janë faktorë që kanë ndikuar në tendencat për largimin nga zonat rurale.

Në zonat rurale, shërbimet e vetme administrative ofrohen përmes 13 zyrave të bashkësive lokale.

Burimi: Hulumtimi në terren; Plani Zhvillimor Urban 2005 - 2015

## SPORTI DHE REKREACIONI

Popullata e re në moshë dhe mundësitetë hapësinore janë potenciale të çmueshme që i posedon Klinë, si në zonën urbane ashtu edhe në hapësirat rurale për zhvillimin e aktivitetetve sportive dhe rekreative. Fatkeqësisht, për shkak të mundësive të kufizuara financiare, përbajtet sportive dhe rekrative në Klinë janë të pakta dhe të pakompletuara. Në qytetin e Klinës janë të vendosura përbajtjet kryesore sportive - stadiumi i qytetit dhe halla sportive (në ndërtim). Stadiumi i qytetit nuk shfrytëzohet rregullisht ka nevojë për përmirësimë dhe plotësimë të përbajtjeve në mënyrë që të shndërrohet në një stadium të denjë të qytetit. Halla e sportit ka nisur të ndërtohet në vitin 2004, por ende nuk është përfunduar.

Përveç këtyre objekteve, përbajtje me rëndësi për zhvillimin e shëndoshë fizik të nxënësve janë përbajtjet sportive në kuadër të shkollave. Salla të edukatës fizike kanë të dy shkollat e mesme (ndërtesa ekzistuese dhe ajo në ndërtim), ndërsa terrene shkollat tjera kanë vetëm terrene të hapura.

Burimi: Hulumtimi në terren

Foto 5. Halla sportive, në ndërtim



Foto 6. Shtëpia e Kulturës, në ndërtim



## KULTURA

Dikur rrjeti i përbajtjeve kulturore, përpos në qytetin e Klinës, ka qenë i përbërë edhe prej ndërtesave në 6 vendbanime tjera - Ujëmirë (me të gjitha hapësirat e nevojshme), Jashanicë (e uzurpuar nga kooperativa bujqësore), Drenoc, Zllakuqan (e shkatërruar), Sverkë (e shkatërruar) dhe Budisalc (e dëmtuar). Sot nuk funksionon asnjë ndërtesë kulturore.

Në qytetin e Klinës ka qenë në funksion shtëpia e kulturës "Jehona e Dukagjinit", në të cilën janë zhvilluar aktivitete nga muzika, teatri, arti figurativ dhe letërsia. Në kuadër të shtëpisë së kulturës ka funksionuar edhe biblioteka e qytetit. Përkundër nevojave, mundësitetë e këtij institucionit për të ofruar kushte për këto aktivitete kanë qenë tejet të kufizuara.

Sot është në ndërtim e sipër ndërtesa e re, si pjesë e rindërtimit të disa pjesëve të qendrës, e cila duhet të ofrojë kushte me bashkëkohore dhe kapacitete më të mëdha për zhvillimin e aktiviteteve kulturore.

Burimi: Hulumtimi në terren;  
Plani Zhvillimor Urban 2005 - 2015

## ZHVILLIMI EKONOMIK

Zhvillimin ekonomik të Klinës duhet shikuar në kontekst më të gjerë dhe përtej kufijve komunal. Pozita e saj në raport me resurset dhe lidhjet me vijat e qarkullimit, paraqet një potencial për shndërrimin e Klinës në një nyje regionale për zhvillimin e bujqësisë dhe veprimtarive përpunuese.

Ekonomia e Klinës është e bazuar në veprimtarinë bujqësore dhe përpunimit të prodhimeve bujqësore. Bujqësia si aktivitet ekonomik është e bazuar në kushtet e mira të tokës bujqësore, pasurisë me rrjedha ujore si dhe të reshurave të cilat në Klinë janë në sasi të volitshme. Në komunën e Klinës 87.7% e tokës është nën 600 m lartësi mbidetare, ndërsa 95% është tokë pjellore. Disa ndërmarrje industriale – bujqësore të periudhës së paraluftës, tani janë në fazën e privatizimit.

Përveç bujqësisë, Kлина shquhet me resurse të pasura natyrore minerale dhe jominerale: rezerva të linjtit, rezerva të boksitit, argilë, rërë dhe zhavorr. Shfrytëzimi i tyre kryesish ka qenë i paorganizuar, përveç boksitit dhe zhavorrit nga Drini në ndërmarrjen Mirusha. Pas luftës shfrytëzimi zhavorrit nga Drini ka shkaktuar probleme të mëdha mjedisore posaçërisht në ruajtjen e resursit ujor të Drinit. Miniera e Boksitit paraqet një resurs i cili do të duhej të aktivizohet në mënyrë që të jetë një prodhim rentabil.

Si resurs i veçantë është edhe parku natyror "Mirusha" i cili me vetitë e rralla estetike, paraqet mundësi për zhvillimin e turizmit me ndikim edhe në qytetin e Klinës. Ujëvarat e Mirushës paraqesin një resurs shumë të rëndësishëm për zhvillimin e turizmit në komunën e Klinës. Këto ujëvare të cilat shtrihen përgjatë rrjedhës së lumit Mirusha, shquhen me vlera të çmueshme natyrore fiziko-gjeografike dhe të florës dhe faunës. Statuti aktual i kësaj zone të mbrojtur është park natyror. Vlerat e tillë mundësojnë jo vetëm turizmin në nivelin lokal, por edhe më gjerë, atë ndërkombëtar. Identifikimi i zonave të zhvillimit dhe hartimi i planit hapësinor të parkut natyror Mirusha, do të mundësonë hapjen e rrugës për investime në turizëm, e rëndësishme posaçërisht për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme të Klinës të cilat merren me turizëm dhe hotelieri. Kjo do të mundësonë edhe krijimin e të ardhurave të rëndësishme për buxhetin komunal.

Ndërmarrjet e mesme dhe të vogla janë të përqendruara kryesisht në qytetin e Klinës, ndërsa në pikëpamje të hapësirës, nuk kërkojnë kushte të posaçme të vendosjes. Shumica e aktiviteteve të banorëve është në veprimtaritë shërbyese – hoteliere dhe zejtare e cila në shumicën e rasteve zhvillohet në kuadër të objekteve të banimit përgjatë rrugëve kryesore.

Përveç veprimtarive shërbyese, pas luftës së fundit në Klinë janë themeluar edhe ndërmarrje prodhuase për nevojat e ndërtimtarisë, të cilat kanë renome edhe në mbarë Kosovën.

Në përgjithësi, në komunën e Klinës janë 941 persona të punësuar në sektorin publik dhe rreth 2000 të punësuar në atë privat, shumica prej të cilëve në qytetin e Klinës.


Për të siguruar një zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, është e domosdoshme që të krijohet një infrastrukturë funksionale. Pas luftës është investuar në përmirësimin e saj, sidomos në përmirësimin e rrjetit rrugor. Lidhjet rrugore dhe hekurudhore të Klinës, sidomos lidhjet me zonën industriale, janë potenciale të rëndësishme që sot shfrytëzohen në shkallë tejet të ulët.

Burimi: Drejtoria e Financave, Ekonomisë dhe Zhvillimit

Plani Zhvillimor Urban 2005 - 2015

Hulumtimi në terren

Harta 7. Investimet kryesore kapitale të komunës në vitin 2010



## MJEDISI FIZIK

### RRJETI I VENDBANIMEVE - GJENDJA NË NIVEL TË KOSOVËS

Në Kosovë janë gjithsej 1457 vendbanime, prej të cilave 37 janë qendra komunale, ndërsa të tjerat për nga përbajtja dhe veprimtaritë kategorizohen si fshatra. Nëse shprehet me përqindje, qendrat komunale përbëjnë 2.5 % të vendbanimeve kosovare. Duke qenë se në këto qendra janë të përqendruara aktivitetet sociale, kulturore, ekonomike, koncentrimi i popullatës është më i madh në to. Kategorizimi i 37 qendrave komunale varësisht sipas numrit të banorëve është prezantuar në tabelën vijuese:

Tabela 12 :

<b>Deri 15.000 banorë</b>	Malisheva, Z.Potoku, Shtërpca, N. Bërdha, H. i Elezit, Mamusha, Juniku, Kllokoti, Graçanica, Ranillugu, Parteshi
<b>15.000—75.000 banorë</b>	Të gjitha komunat tjera ( <b>duke e përfshirë edhe Klinën</b> )
<b>75.000 – 120.000 banorë</b>	Gjilani, Gjakova, Peja, Mitrovica, Vushtrria, Podujeva
<b>120.000- 220.000 banorë</b>	Prizreni
<b>&gt; 220 000 banorë</b>	Prishtina

Vendbanimet më afër magjistraleve dhe zonës urbane janë më të zhvilluara andaj është analizuar edhe afërsia e vendbanimeve dhe popullsisë ndaj rrugëve magjistrale dhe regionale. Rreth 80% e popullsisë shtrihet në një distancë më të vogël se 20 km nga 7 qendrat rajonale që kanë mbi 100000 banorë. Kjo e bën mjaft specifik relacionin midis zhvillimit urban dhe rural të Kosovës nga aspekti i rëndësisë së zhvillimit të transportit midis këtyre qendrave rajonale dhe vendbanimeve përreth tyre.

### VENDBANIMET NË KOMUNËN E KLINËS

**Komuna e Klinës** përbëhet prej 54 vendbanimeve, ndërsa qyteti i Klinës është qendër komunale. Vendbanimet tjera kategorizohen si fshatra, ndërsa për nga përbajtjet dallohet Zllakuqani, i cili mund vlerësohet se ka disa elemente urbane.


Në të gjitha vendbanimet e Komunës së Klinës, deri diku edhe në periferi të qendrës komunale, ka mbizotëruar popullsia bujqësore. Si rrjedhojë, vendbanimet e komunës së Klinës, kryesisht kanë ruajtur karakterin e tyre bujqësor.

Qyteti i Klinës ka qenë vendbanimi më i madh, si qendër komunale. Sot qyteti i Klinës ka rreth 8000 banorë, që përbën rreth 14.5% të banorëve të komunës.

Në periudhën e pasluftës ka pasur ndryshime në numrin e banorëve dhe përbërjen e vendbanimeve. Sot, madhësia mesatare e vendbanimeve është rreth 900 banorë, duke mos llogaritur qytetin e Klinës. Për nga numri i banorëve, si fshatra më të mëdha dallohen Zllakuqani, Grabanica, Jashanica dhe Ujëmiri. Kлина përfshinë rreth 14.5% të banorëve të komunës.

Diagrami6. Shpërndarja e banorëve sipas terhive lokale

ZYRA E VENDIT	NUMRI I VEND-BANIMEVE	NUMRI I BANORËVE
KLINË	11	20000
BUDISALC	5	3000
ZLLAKUQAN	5	4500
DRENOC	9	5000
JASHANICË	6	7500
UJMIRË	4	6500
GLLAREVË	4	6000
SFERKË	5	8000
SHTUPEL	5	1630
<b>GJITHSEJ</b>	<b>54</b>	<b>62130</b>



**Tipologja dhe klasifikimi i vendbanimeve**—Klasifikimi i vendbanime sipas madhësisë, pozitës gjeografike, karakteristikave topografike dhe lidhjeve me rrjetin e trafikut është mjaftë me rëndësi për përcaktimin e kushteve të vendbanimeve, si dhe rolit dhe rëndësisë së tyre në kuadër të rrjetit të vendbanimeve. Sipërfaqja e gjithëmbarshme e komunës është  $308.8 \text{ km}^2$ , prej të cilës rrëth  $18\text{km}^2$  përfshijnë vendbanimet (hapësira e ndërtuar), përkatësisht rrëth  $5.8\%$ .

Në komunën e Klinës mbizotërojnë vendbanimet e tipit të lagjeve të shpërndara, si rezultat i organizimit shoqëror dhe mënyrës së jetesës, si dhe për shkak të morfologjisë së terrenit. Prej 54 vendbanimeve, 44 (81.5%) janë të zhvilluara në formë të lagjeve të shpërndara, ndërsa 10 (18.5%) janë të grumbulluara. Në pjesën më të madhe, vendbanimet janë zhvillura në mënyrë të lirë, jashtë planifikimit.

Pozita, shpërndarja dhe shtrirja e vendbanimeve është rezultat i reliefit dhe i elementeve të tjera të bazës natyrore-gjeografike. Nëse nisemi nga tërësitë relijiore gjeografike, në komunën e Klinës kemi vendbanimet të rrafshëta dhe vendbanimet në terrene të valëzuara. Vendbanimet e rrafshëta gjenden në pjesën fushore, luginave përgjatë lumenjve, buzë luginave, ose rrugëve kryesore ose anësore dhe janë më të përqendruara, ndërsa disa janë edhe në formë të zgjatur. Prej numrit të përgjithshëm të vendbanimeve në komunë, vendbanimet të rrafshëta janë 12, përkatësisht 22.2%. Në kuadër të vendbanimeve të rrafshëta përfshihet edhe qyteti i Klinës. Vendbanimet në terrenet e valëzuara kodrinore, shtrihen kryesisht rrëzë kodrave, shpatave, dhe nëpër qafa. Në kuadër të tyre përfshihet shumica e vendbanimeve të komunës, 42 sosh, përkatësisht 77.7%.

**Klina** ka një pozitë qendore në komunë. Shtrihet 55 km larg Prishtinës dhe 28 km larg Pejës. Hapësira e qytetit është e përkufizuar me rrjedhjen e lumejve Drini i Bardhë dhe Klina, si dhe me kodrën e Krushevës në veri. Në kuptim të lidhjeve trafikore paraqet qendër të rëndësishme, duke qenë se në qendër të saj kryqëzohen drejtimet për magjistrale, Istog dhe Skenderaj. Po ashtu, në anën lindore të saj, vija hekurudhore nga Fushë Kosova ndahet drejtim të Pejës dhe Prizrenit, duke qenë nyja e dytë hekurudhore për nga rëndësia në Kosovë.

Në pjesën më të madhe Klina shtrihet në një terren të rrafshët në lartësi mbidetare prej rrëth 380 m, ndërsa në pjesën veriore shtrihet në terren të pjerrët, në lartësi mbidetare deri 415 m. Zona urbane e Klinës përfshinë  $439.6 \text{ ha}$ , prej të cilës sipërfaqja e ndërtuar dhe ajo e transportit përfshinë  $195 \text{ ha}$ . Dendësia e ndërtimit është më e theksuar në qendër dhe përgjatë rrugëve kryesore, ku viteve të fundit kanë filluar të shtohen ndërtesat shumëkatëshe, deri sa në pjesët periferike kjo dendësi është shumë më e ulët, kryesisht me lagje shtëpish individuale të shpërndara në toka punuese.

Përbajtjet kryesore publike në nivel të komunës janë të përqendruara në Klinë, duke përfshirë përbajtjet arsimore, shëndetësore, administrative dhe kultuore. Ky përqendrim i përbajtjeve në Klinë dhe mungesat e disa shërbimeve në vandbanimet tjera, ka rezultuar me rritje të numrit tëbanorëve gjatë viteve dhe zgjerim të zonës së ndërtuar. Vlerësohet se Kлина i ka rreth 8000 banorë.

Përveç funksionit si qendër komunale, në Klinë funksionon edhe Zyra e Vendit në të cilën gravitojnë fshatrat Dollci, Dërsnik, Gremnik, Zajm, Videjë, Deiq, Krushevë e Vogël, Gjurgjevik i Vogël, Klinafc dhe Jagodë.

**Dollci** gjendet në veri të magjistrales Prishtinë - Pejë, përkatësisht rreth 1.5km në lindje të rrugës që e lidh qytetin e Klinës me magjistrale dhe rreth 1.1km në lindje të hekurudhës Klinë - Prizren. Shtrihet në një terren kodrinor, me lartësi mbidetare 385 - 430 m. Është vendbanim i shpërndarë me lagje dhe përfshinë sipërfaqe prej rreth 18 ha.

Në pjesët e ulëta karakterizohet me shtëpi të reja, ndërsa në pjesët e sipërme ende ka shtëpi të shkatërruara, në disa raste me shtipi të reja pranë. Në fshat gjendet një ndërtesë e vjetër shkollore, e cila nuk është në funksion.

**Dërsniku** gjendet në lindje të Klinës, rreth 2 km nga lagja "Arbëria". Shtrihet në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 420 - 460 m përgjatë rrugës lokale që vazhdon deri në lumin Kлина. Është vendbanim i shpërndarë me lagje dhe përfshinë sipërfaqe prej rreth 47.5 ha.

Fshati karakterizohet me shtëpi të reja, ndërsa nëpër disa pjesë hasen shtëpi të shkatërruara, në disa raste me shtëpi të reja pranë. Në fshat gjendet edhe një kapellë ortodokse.

**Gremniku** gjendet në lindje të rrugës regionale për Gjakovë, rreth gjysëm kilometri nga kryqëzimi me magjistrale. Shtrihet në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 380 - 430m. Ka qenë vendbanim kryesisht i përmbledhur, por me ndërtimet e reja përgjatë rrugës regionale, ështu duke kaluar në një vendbanim të shpërndarë me lagje. Përfshinë sipërfaqe prej rreth 29.5ha.

Përveç banimit dhe veprimtarive bujqësore, fshati karakterizohet edhe me veprimtari tjera, kryesisht shërbyese dhe tregtare, të cilat zhvillohen përgjatë rrugës regionale. Në fshat funksionon edhe shkolla fillore "Zgjimi"

Foto 7. Kлина



Foto 8. Dollci



Foto 9. Gremniku



Foto 10. Zajmi



Foto 11. Videjë, qendra e komunitetit



Foto 12. Krusheva e Vogël



**Zajmi** shtrihet në terren të rrafshët, me qasje të drejpëdrejtë në magjistrale, rrreth 1.5 km në perëndim të udhëkryqit të Klinës. Në pjesën më të madhe zhvillohet në veri të magjistralës, në një lartësi mbidetare prej 380 - 390 m. Lumi Drini i Bardhë që rrjedh në lindje të fshatit, ofron mundësi të mira për bujqësi. Fshati është i zhvilluar si i shpërndarë me lagje dhe përfshinë sipërfaqe prej rrreth 59 ha.

Në Zajm funksionon paralelja e ndarë e shkollës fillore "Motrat Qiriazi" të Klinës. Fshati ka po ashtu edhe kishën e vet katolike.

**Videja** gjendet rrreth 1.5 km në perëndim të Drinit të Bardhë, përgjatë rrugës lokale shtrihet paralel me këtë lum, që lidhet me Zajm dhe magjistrale. Shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare prej 385 m. Fshati është i tipit të përbledhur dhe përfshinë sipërfaqe prej rrreth 41.5 ha.

Shtëpitë në këtë fshat janë kryesisht në gjendje të mirë, ndërsa nëpër disa pjesë hasen shtëpi të shkatërruara, në disa raste me shtipi të reja pranë. Institucioni i vetëm që funksionon në këtë lagje është një qendër e komunitetit, pranë të cililit ka edhe hapësirë dhe rekuizita për lojë të fëmijëve, që kanë nevojë për mirëmbajtje.

**Deiqi** gjendet në jug të Videsë, rrreth 1 km në perëndim të Klinës, pranë Drinit të Bardhë. Shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare prej rrreth 375 - 395 m. Fshati është i zhvilluar si i shpërndarë në lagje, përgjatë dy rrugëve paralele, në drejtim veri-jug. Zona e ndërtuar e fshatit përfshinë rrreth 26.4ha.

Në fshat nuk ka ndonjë përbajtje publike.

**Krusheva e Vogël** gjendet në veri të Klinës, në të dy anët e rrugës Klinë - Istog, rrreth 1.2km larg Klinës dhe pranë Drinit të Bardhë. Shtrihet në terren të pjerrët kodrinor, në lartësi mbidetare që ndryshon prej 380 deri në 460 m. Fshati është i zhvilluar si i shpërndarë në lagje, të cilat janë të shpërndara prej lartësive në pjesën kodrinore deri te pjesët e ulëta pranë Drinit të Bardhë. Sipërfaqja e ndërtuar përfshinë rrreth 34.8ha.

Përveç shtëpive të banimit, fshati nuk ka ndonjë ndërtesë të karakterit tjetër.

**Gjurgjeviku i Vogël** shtrihet në terren kodrinor në veri të Klinës, rreth 2 km distancë rrugore nga Kлина. Është vendbanim i zhvilluar në lagje, që shtihen në një territor me lartësi të ndryshueshme mbidetare, prej 420 deri në 520 m.

Në fshat funksionon paralelja e ndarë e shkollës filllore “Ismet Rraci” të Klinës.

**Klinafci** shtrihet në terren kodrinor në verilindje të Klinës, dhe përmes dy rrugëve lokale ka qasje në rrugën regionale Klinë - Skenderaj, afër zonës industriale. Shtëpitë e para janë rreth 700 m larg rrugës regionale. Fshati zhvillohet si i shpërndarë në lagje, në terren të pjerrët kodrinor, në lartësi mbidetare që ndryshon prej 450 deri në 490 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit është rreth 4 ha.

Përveç shtëpisë të banimit, fshati nuk ka ndonjë ndërtuesë të karakterit tjetër. Rrugët në tërësi janë nga dheu dhe zhavori.

**Jagoda** shtrihet në veriperëndim të Klinës, përgjatë rrugës lokale Klinë - Budisalc, rreth 3 km distancë rrugore nga Kлина. Është fshat i zhvilluar në gjatësi, i shpërndarë me lagje dhe shtrihet në terren të pjerrët në lartësi mbidetare 395 - 435 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit është rreth 26.15ha. Paralel me shtrirjen e fshatit kalon vija hekurudhore Klinë - Pejë, ndërsa vendkalimet mbi hekurudhë janë të pambrojtura.

Në fshat funksionon shkolla filllore “Atë Gjergj Fishta” dhe ambulanca e fshatit. Një terren sportiv gjendet në anën veriore të rruges lokale. Në pjesën veriore të fshatit gjendet kisha katolike.

**Budisalci** është qendër lokale, në të cilën gravitojnë fshatrat Rudicë, Krushevë e Madhe, Stupë dhe Nagllavë. Gjendet në veriperëndim të Klinës, përgjatë rrugës lokale Klinë - Budisalc, rreth 8 km distancë rrugore nga Kлина. Është fshat i përbledhur në terren të rrafshët, në rreth 415 m lartësi mbidetare. Përmes fshatit kalon vija hekurudhore Klinë - Pejë, ndërsa vendkalimet mbi hekurudhë janë të pambrojtura.

Për rëndësinë e k[ti] vendbanimi dëshmojnë objektet fetare: kisha ortodokse në pjesën perëndimore të fshatit, e ndërtuar në shekullin XVI, si dhe kisha katolike në qendër të fshatit. Stacioni hekurudhor, indërtuar në vitet '30 të shekullit të kaluar, dëshmon edhe për rëndësinë e Budisalcit në fillet e zhvillimit të rrejit hekurudhor. Sot ky stacion është jashtë funksionit.

Prej institucioneve publike, në fshat funksionon shkolla filllore “Nëna Terezë” si dhe zyra e vendit.

Foto 13. Gjurgjeviku i Vogël



Foto 14. Jagodë, shkolla filllore “Atë Gjergj Fishta”



Foto 15. Budisalc, ndërtesa e vjetër e stacionit helurudhor



Foto 16. Rudica



**Rudica** është vendbanim i shpërndarë me lagje, që në pjesën më të madhe shtrihet në hapësirën në mes Drinit të Bardhë dhe Lumit të Istogut. Fshati ka qasje në rrugën regionale Klinë - Istog, si dhe në rrugën lokale Klinë - Stupë, përmes Budisalcit, ndërsa largësia rrugore nga Klina është rreth 10 km. Shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 405 - 415 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 31 ha.

Fshati përbehet kryesisht prej shtëpive të veçanta të banimit.

**Krusheva e Madhe** është vendbanim i tipit të shpërndarë me lagje që shtrihet në hapësirën në mes Drinit të Bardhë dhe hekurudhës Klinë - Pejë. Ka qasje në rrugën regionale Klinë - Istog, me kalim mbi Drinin e Bardhë, si dhe në rrugën lokale Klinë - Stupë, me kalim mbi hekurudhë. Largësia rrugore nga Klina është rreth 6 km. Fshati shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 395 - 400 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 52 ha.

Fshati përbehet kryesisht prej shtëpive të veçanta të banimit.

**Stupa** gjendet afër kufirit komunal, në skajin veriperëndimor të saj. Gjendet në largësi prej rreth 10 km nga Klina. Është fshat i shpërndarë me lagje i shtrirë në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 415 - 420 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 5.5 ha.

Fshati përbehet kryesisht prej shtëpive të veçanta të banimit.

**Nagllava** gjendet shumë afër Budisalcit, në anën juglindore të tij, pranë hakurudhës Klinë - Pejë. Është fshat i shpërndarë me disa lagje, i shtrirë në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 415 - 412 m.

Fshati përbehet kryesisht prej shtëpive të veçanta të banimit.

Foto 17. Krusheva e Madhe



Foto 18. Nagllava



**Drenoci** është qendër lokale, në të cilën gravitojnë fshatrat Grabanicë, Pjetërq i Poshtëm, Pjetërq i Epërm, Bokshiq, Dollovë, Këpuz dhe Qeskovë. Shtrihet pranë magjistraleve Prishtinë - Pejë, rreth 5 km nga udhëkryqi i Klinës. Fshati është i tipit të shpërndarë në lagje, në lartësi mbidetare 390 - 460, në pjesën më të madhe në terren kodrinor në veri të magjistraleve. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 50 ha.

Në fshat funksionon shkolla fillore "Isa Boletini", ambulanca e fshatit si dhe zyra e vendit.

**Grabanica** shtrihet në jug të Lumbardhit, rreth 1.5 km largësi rrugore nga magjistrala (kryqëzimi te Zajmi). Hapësira e fshatit dhe tokave përreth është kufizuar me meandrat e Lumbardhit në veri dhe perëndim dhe me rrugën lokale Zajm - Dollovë lindje. Fshati përbëhet nga lagje të shpërndara që shtrihen përgjatë rrugës lokale Zajm - Dugajevë. Në pjesën më të madhe shtrihet në terren të rrafshët, ndërsa lartësia mbidetare sillet nga 375 në 395 m.

Në fshat funksionon shkolla fillore "Azem Bejta", si dhe ambulanca e fshatit.

**Pjetërqi i Poshtëm** shtrihet pranë magjistraleve Prishtinë - Pejë, rreth 7 km largësi rrugore nga udhëkryqi i Klinës. Fshati është i shpërndarë në lagje dhe në pjesën më të madhe shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 395 - 415m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 14.5 ha.

Në fshat funksionon paralelja e ndarë e shkollës fillore "Isa Boletin" të Drenocit.

**Pjetërqi i Epërm** shtrihet në jug të magjistraleve Prishtinë - Pejë, rreth 8 km largësi rrugore nga udhëkryqi i Klinës. Fshati shtrihet në terren të rrafshët, hapësira e të cilit në veri kufizohet me rrugën magjistrale, ndërsa në jug me Lumbardhin e Pejës. Është fshat i shpërndarë në lagje, në lartësi mbidetare prej rreth 395 m, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar përfshinë rreth 26 ha.

Foto 19. Drenoc - Zyra vendore, objekti i ri dhe i vjetër



Foto 20. Grabanicë, shkolla fillore "Azem Bejta"



Foto 21. Pjetërqi i Poshtëm



Foto 22. Pamje nga Bokshiqi



Foto 23. Këpuz, paralelja e ndarë e sh.f. "Azem Bejta"



Foto 24. Qeskova



**Bokshiqi** shtrihet afër kufirit komunal, përgjatë rrugës lokale Zajm - Grabanicë - Gllogjan, rreth 3.5 km largësi rrugore nga kyçja në magjistrale në fshatin Zajm. Është fshat kodrinor, i shpërndarë në lagje, në lartësi mbidetare 420 - 440 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 12 ha.

**Dollova** shtrihet në perëndim të Drinit të Bardhë, në pjesën më të madhe në terren të rrafshët. Lagja më e madhe e fshatit gjendet në kryqëzimin e rrugëve lokale Zajm - Këpuz dhe Zajm - Çeskovë, rreth 4 km distancë rrugore nga kyçja në magjistrale në fshatin Zajm. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 8 ha, ndërsa shtrihet në lartësi mbidetare prej rreth 370 m.

**Këpuzi** shtrihet rreth 7.5 km distancë rrugore nga kyçja në magjistrale në fshatin Zajm, ndërsa nga ky fshat rruga lokale ndahet në drejtim të fshatit Qeskovë dhe fshatit Mrasor (Komuna e Gjakovës). Këpuzi është fshat i përbledhur, që shtrihet në terren të pjerrët, në lartësi mbidetare prej 425 deri 440 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 9.5 ha.

Në fshat funksionin paralelja e ndarë e shkollës fillore "Azem Bejta" të Grabanicës.

**Qeskova** shtrihet përgjatë rrugësl okale Zajm - Dollovë - Nepolë, rreth 6.5 km largësi rrugore nga kyçja në magjistrale në fshatin Zajm. Qeskova është fshat i shpërndarë në lagje, në terren kodrinor, afër kufirit komunal. Shtrihet në lartësi mbidetare prej 430 deri në 455 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 8.5 ha.

**Jashanica** është qendër lokale, në të cil[n gravitojnë fshatrat Pograxhë, Resnik, Jelloc, Dush dhe Gjurgjevik i Madh. Shtrihet në verilindje të Klinës rreth 5 km larg saj, me qasje në rrugën regionale Klinë Skenderaj. Është fshat me lagje të shpërndara në një territor të gjerë, nëpër një terren të valëzuar kodrinor, në lartësi mbidetare 430 - 475 m. Sipërfaqja e ndërtuar përfshinë rreth 67 ha.

Meqenëse Jashanica është qendër lokale, në të gjenden disa përbajtje publike. Zyra lokale e ka ndërtesën e re. Shkolla fillore "Tre Dëshmorët", për shkak të shtrirjes së gjerë të fshatit, funksionon në dy ndërtesa -

ndërtesa kryesore dhe paralelja e ndarë. Në Jashanicë funksionon edhe ambulanca e fshatit.

Foto 25. Jashanicë, ambulanca

**Pograxha** shtrihet në verilindje të Klinës, rreth 4 km larg saj, me qasje në rrugën regionale Klinë - Skenderaj. Shtrihet në terren kodrinor, në lartësi të ndryshueshme mbidetare prej 435 deri 475 m. Në anën per[ndimore kufizohet me lumin Kлина dhe terrene të ngritura, ndërsa në perëndim kufizohet me rrugën regionale. Është fshat i shpërndarë në lagje, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar përshinë rreth 19 ha.

**Resniku** shtrihet në terren kodrinor në verilindje të Klinës, me qasje në rrugën regionale Klinë - Skenderaj (përmes Jashanicës së Epërme), në distancë rrugore 9 km nga Kлина. Është fshat i shpërndarë në lagje, në lartësi të ndryshueshme mbidetare prej 490 deri 540 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 15.5 ha.



Foto 26. Pograxhë, ura mbi lumin Kлина

Në fshat funksionon paralelja e ndarë e shkollës filllore "Tre Dëshmorët" të fshatit Jashanicë.

**Jelloci** shtrihet në terren kodrinor në verilindje të Klinës, me qasje në rrugën regionale Klinë - Skenderaj (përmes Pograxhës), në distancë rrugore 8 km nga Kлина. Është fshat i shpërndarë në lagje, në lartësi mbidetare prej 450 deri 465 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 14.5 ha.

**Dushi** shtrihet përgjatë drejtimit hekurudhor Klinë - Fushë Kosovë, në verilindje të Klinës, me qasje nga rruga regionale Klinë - Skendraj, përmes fshatrave Pograxhë dhe Jashanicë. Fshati është rreth 6 km larg Klinës dhe është i shpërndarë në lagje, në terren kodrinor me lartësi mbidetare 430 - 465 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 13 ha.



Foto 27. Gjurgjeviku i Madh

**Gjurgjeviku i Madh** është fshat me lagje të shpërndara nëpër një hapësirë të gjerë në lindje t [ Klinës. Kjo hapësirë në veri kufizohet me lumin Kлина dhe hekurudhën Klinë - Fushë Kosovë, ndërsa në tëgjitha anët tjera kufizohet me terrene të ngrituar kodrinore. Fshati ka qasje prej rrugës magjistrale përmes Ujmirit, si dhe prej rrugës regionale Klinë - Skenderaj, përmes Pograxhës dhe Jashanicës. Shtrihet në terren kodrinor me lartës mbidetare prej 435 deri 582 m.

Në fshat funksionon paralelja e ndarë e shkollës filllore "Tre Deshmorët" të Jashanicës.



Foto 28. Ujmir, zyra e vendit dhe QMF



**Ujmiri** është qendër lokale, në të cilin gravitojnë fshatrat Çabiq, Siqevë dhe Dobërdol. Shtrihet në lindje të Klinës, me qasje nga rruga magjistrale Prishtinë - Pejë, rreth 14 km largësi rrugore nga udhëkryqi i Klinës. Fshati ka qasje edhe prej rrugës regionale Klinë - Skenderaj, përmes fshatrave Pograxhë, Jashanicë, Dush dhe Gjurgjevik i Madh. Është fshat me lagje të shpërndara në një territor të gjërë, përmes të cilit kalon lumi Klina dhe hekurudha Kljinë - Fushë Kosovë. Shtrihet në terren të valëzuar kodrinor, në lartësi mbidetare 455 - 500 m, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar përfshinë rreth 40 ha.

Në fshat gjendet shkolla fillore "Ali Krasniqi", Qendra e Mjekësisë Familjare (prej gjithsej tri sa gjenden në komunë), si dhe zyra e vendit, e cila funksionin në të njejtën ndërtesë me QMF. Përveç këtyre përbajtjeve, në fshat gjendet edhe ndërtesa e vjetër e stacionit hekurudhor, e cila dëshmon përrëndësinë që ka pasur Ujmiri në fillet e zhvillimit të rrjetit hekurudhor në Kosovë.

**Çabiqi** gjendet në pjesën lindore të komunës. Qasjen më të shkurtë e ka nga magjistrala Prishtinë - Pejë, nga udhëkryqi i Kijevës, përmes Cerovikut. Është fshat i përbledhur në terren kodrinor, me lartësi mbidetare 560 - 620 m.

Në fshat funksionon paraleja e nda rë e shkollës fillore "Ali Krasniqi" të Ujmirit.

**Siqeva** është fshat me lagje të përhapura në një hapësirë të gjerë në lindje të komunës dhe në veri të lumit Klina. Fshati ka qasje nga rruga magjistrale, përmes Ujmirit, si dhe nga rruga regionale Klinë - Skenderaj, përmes fshatrave Pogrëgjë, Jashanicë dhe Dush. Shtrihet në terren kodrinor, me lartësi mbidetare 445 - 615 m, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 53 ha.

Në fshat funksionin shkolla fillore "Ymer Berisha"

**Dobërdoli** shtrihet në lindje të Klinës dhe në veri të rrugës magjistrale, nga e cila ka qasje përmes fshatit Rigjevë. Është fshat me lagje të shpërndara në terren kodrinor, me lartësi mbidetare 545 - 610 m. Sipërfaqaje e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 7 ha.

Foto 29. Çabiqi



Foto30.. Siqeva



**Gllareva** është qendër lokale në të cilën gravitojnë fshatrat Rixhevë, Carravik dhe Zabërgjë. Shtrihet pranë magjistrles Prishtinë - Pejë, rreth 7.5 km nga udhëkryqi i Klinës. Është fshat me lagje të shpërndara në një hapësirë të gjërë kodrinore, në të dy anët e rrugës magjistrale. Shtrihet në hapësirë me lartësi të ndryshueshme mbidetare 565 - 600 m, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 27 ha.

Në Gllarevë funksionon zyra lokale, shkolla fillore "Dëshmorët e Qëndresës", si dhe ambulanca e fshatit.

Edhe pse në shumicën e rasteve udhëtarët vetëm kalojnë pranë Gllarevës, pothuaj se të gjithëve ju bëjnë përshtypje rrasat e renditura për shitje pranë magjistrales. Ky fakt bën që rrasat të jenë një element identifikues i fshatit.

**Rixheva** shtrihet përgjatë magjistrales Prishtinë - Pejë, rreth 10 km në lindje të udhëkryqit të Klinës. Është fshat i shpërndarë në disa lagje, në terren kryesisht të rrafshët, në lartësi mbidetare 575 - 610 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 49 ha.

**Caraviku** është fshati më i skajshëm lindor i komunës së Klinës. Shtrihet në veri të magjistrales Prishtinë - Pejë, nga e cila ka qasje përmes udhëkryqit të Kijevës, dhe është rreth 14.5 km larg nga udhëkryqi i Klinës. Është fshat me lagje të shpërndara në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 575 - 630 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 29 ha.

Në fshat funksionon shkolla fillore "Esad Mekuli", si dhe ambulanca e fshatit. Është ndërtuar edhe objekti për zyre të vendit, por nuk është vënë në funksion, pasi fshati ende nuk e ka statusin e qendrës lokale.

**Zebërgja** shtrihet në lindje të Klinës dhe në veri të rrugës magjistrale, nga e cila ka qasje përmes fshatit Rigjevë, dhe gjendet rreth 12 km nga udhëkryqi i Klinës. Është fshat me lagje të shpërndara në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 575 - 610 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 9 ha.

Foto31. Rrasat e Gllarevës



Foto32. Rixheva



Foto33. Carravik, shkolla fillore "Esad mekuli"



Foto34. Sferkë, QMF dhe zyra e vendit



Foto 35. Dushi i Vogël



Foto 36. Volljakë, paralelja e ndarë e shkollës filllore "Emin Duraku" të Sferkës



**Sferka** është qendër lokale në të cilën gravitojnë fshatrat Dush i Vogël, Volljakë, Qypevë dhe Përqevë. Shtrihet në jug të komunës, në hapësirë me ineters të veçantë në të cilën gjenden vendburimet e bokshitit dhe e cila kufizohet me zonën e Mirushës. Qasja në fshat bëhet nga rruga regionale për Gjakovë, përmes fshatit Volljakë, ndërsa distanca rrugore nga kryqëzimi i rrugës regionale me rrugën magjistrale Prishtinë - Pejë është rreth 9.5 km. Sferka është fshat i shpërndarë në lagje, i shtrirë në terren të valëzuar, në lartësi mbidetare 525 - 555 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 60 ha.

Në Sferkë funksionon shkolla fillore "Emin Duraku", Qendra e Mjekësiseë Familjare (nga gjithsej tri që gjenden në komunë) si dhe zyra e vendit.

**Dushi i Vogël** është fshati më jugor i komunës, rreth gjysëm kilometri larg lumit Mirusha, që shënon kufirin komunal me Malishevën. Qasja në fshat bëhet nga rruga regionale për Gjakovë, përmes fshatit Volljakë. Është fshat i shpërndarë në lagje, në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 515 - 530 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 6.5 ha.

**Volljaka** është fshat emri i të cilit është i njohur për shkak të minierës së bokshitit që gjendet në afërsi të saj, në anën veriperëndimore. Është fshat kryesisht i përbledhur që shtrihet në terren të valëzuar, në lartësi mbidetare 510 - 540 m. Qasja në fshat bëhet nga rruga regionale për Gjakovë, ndërsa distanca rrugore nga kryqëzimi i rrugës regionale me rrugën magjistrale Prishtinë - Pejë është rreth 6.5 km. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 15 ha.

Në Volljakë funksionon paralelja e ndarë e shkollës filllore "Emin Duraku" të Sferkës.

**Qypeva** shtrihet përgjatë rrugës regionale për Gjakovë, rreth 2 km nga kryqëzimi i kësaj rruge me magjistralen Prishtinë - Pejë. Hekurudha Klinë - Prizren e kufizon hapësirën e fshatit kah ana perëndimore. Është fshat i shpërndarë në lagje dhe shtrihet në terren të rrafshët, në lartësi mbidetare 365 - 385 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 5.5 ha.

**Përqeva** shtrihet në verilindje të minierës se bokshitit, me qasje nga magjistrala Prishtinë - Pejë, përmes Gllarevës, si dhe nga rruga regionale për Gjakovë, përmes Volljakës dhe Sferkës. Është fshat i përbledhur që shtrihet në terren të valëzuar, në lartësi mbidetare 585 - 635 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 21 ha.

Në Përqevë funksionon edhe paralelja e ndarë e shkollës "Emin Duraku" të Sferkës.

**Shtupeli** është qendër lokale në të cilën gravitojnë fshatrat Kërnicë, Bingjë, Grapc dhe Dranashiq. Shtrihet në terren kodrinor në veri të Klinës, ndërsa ka qasje nga rruga regionale Klinë - Istog përmes Zllakuqanit, si dhe përmes rrugës regionale Klinë - Skenderaj përmes Kërnicës. Është fshat i shpërndarë në lagje, në lartësi mbidetare 425 - 495 m. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 37 ha.

Në Shtupel funksionon shkolla fillore "Avni Zhabota", ambulanca e fshatit, si dhe zyra lokale.

Foto 37. Shtupel, shkolla fillore "Avni Zhabota"



**Kërnica** shtrihet në veriperëndim të rrugës regionale Klinë - Skenderaj, rreth 5 km nga Klina. Është fshat i shpërndarë në lagje, në terren kodrinor, në lartësi mbidetare prej rreth 480 - 525 m. Sipërfaqje e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 8 ha.

Në fshat funksionon paralelja e ndarë e shkollës fillore "Avni Zhabota" të Shtupelit.

Foto 38. Kërnica

**Bingja** është një fshatrat më veriorë të komunës, me lagje të shpërndara në terren kodrinor. Qasja në këtë fshat bëhet nga rruga regionale Klinë - Istog, përmes fshatrave Gjurgjevik i Vogël dhe Shtupel, si dhe prej rrugës regionale Klinë - Skenderaj përmes fshatit Grapc. Fshati shtrihet në terren me lartësi të ndryshueshme mbidetare 490 - 555 m, ndërsa sipërfaqja e ndërtuar përfshinë rreth 17 ha.

**Grapci** është po ashtu njëri ndër fshatrat me veriorë të komunës. Është fshat i shpërndarë në lagje, në terren kodrinor me lartësi mbidetare 480 - 530 m. Qasje në këtë fshat bëhet përmes rrugës regionale Klinë - Skenderaj. Sipërfaqja e ndërtuar e fshatit përfshinë rreth 6 ha.




Foto 39. Bingja


**Dranashiqi** është një fshat i vogël, në lindje të Bingjës, përmes të cilit lidhet me pjesët tjera të komunës. Shtrihet në terren kodrinor, në lartësi mbidetare 500 - 511 m.



Harta8. Katagorizimi i vendbaneve në Komunën e Klinës



Harta9. Shpërndarja e vendbaneve në raport me relievin



Burimi: Agriculture Land Utilisation Project - ALUP

## **VENDBANIMET JOFORMALE**

Vendbanimet joformale në vendin tone kanë ekzistuar edhe më parë, mirëpo kryesisht kanë qenë të njoitura me emërtime të ndryshme si lagje të egra ,ilegale, të paplanifikuara, mahalla etj. Sipas Ligjit Nr. 03/L-106 për ndryshimin e Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.2003/14 ,Neni 2 Vendbanimet Joformale përkufizohen si në vijim: janë vendbanime njerëzore të cilat nuk u mundësojnë banorëve të gjelqinë të drejtat e tyre për një standard të përshtatshëm të jetesës , në veçanti banim të përshtatshëm .Si të tilla, vendbanimet joformale duhet të kenë karakteristika si në vijim:

1. Zotërimi joformal i pronësisë,
2. Qasja joadekuate ose privimi në shërbime elementare,
3. Pjesëmarrja joadekuate ose mos pjesëmarrja në qeverisje dhe
4. Rrezikshmëria e lartë

VBJ e identifikuara në vendin tonë, karakterizohen kryesisht me zotërim joformal të pronësisësi dhe me qasje joadekuate në shërbime elementare.Karakteristikat identifikuase do të jenë bazë për të ju çasur rregullimit të tyre.

Gjendja aktuale e VBJ-ve në Kosovë është rrjedhë e mungesës së qasjes në banim të përshtatshëm për një kategori të popullatës si dhe mosgatishmëria të paraprihet me plane hapësinore dhe urbanistike për të ofruar tokë urbane për ndërtim. Andaj faktorët vijues kon siderohen si shkaktarë të krijimit të VBJ-ve në vendin tone:

- **Urbanizimi i shpejtë;**
- **Mungesë e menaxhimit të tokës në hap me kohën**
- **Mungesë e menaxhimit efektiv të planifikimit hapësinor dhe kontrollit të zhvillimeve**
- **Mungesë e politikës për ofrim të banimit të përshtatshëm**
- **Mungesë e resurseve humane,financiare dhe teknike të autoriteteve qendrore dhe lokale**


Bazuar në të dhenat nga MMPH në komunat e Kosovës janë identifikuar 174 vendbanime joformale. Në komunën e Klinës janë identifikuar 21 Vendbanime Joformale. Prej tyre 1 VBJ gjendet në zonën urbane , ndërsa 20 në zonën rurale. Këto janë: Rudicë, Budisalc, Jagodë, Bërkovë, Shtupel, Bingjë, Pogradjë, Petriq I poshtëm, Drenoc, Dugajë, Grabanicë, Zajm, Klinë –zona veriore, Klinë-Dërrsnik, Dollovë, Volljakë, Strapanicë, Resnik, lagja në mes të Jashanicës dhe Jashanicës së Epërme.

Në këto vendbanime jetojnë banorë të komunitetit shqiptar, serb(ka raste të zhvendosjes pas vitit 1999 ) dhe RAE. Karakterizohen me mungesë të pjesshme të infrastrukturës sociale dhe fizike, kanë ndikim negativ në mjedis dhe zotërim joformal të pronës.


Sipërfaqja e që përfshijnë vendbanimet joformale përfshinë rreth 1137 ha. Numri i shtëpive që përbëjnë vendbanimet joformale është rret 1635, ndërsa në to jetojnë rreth 10696 banorë, që përbëjnë rreth 19.5% të banorëve të komunës.

Burimi: Raporti i gjendjes së vendbanimeve joformale në Kosovë, MMPH, 2010

Harta10. Zonat e vendbanimeve joformale (sipas MMPH)



Harta11. Shërbimet publike në komunë



## BANIMI SI FUNKSION DHE KARAKTERISTIKAT THEMELORE TË FONDIT TË BANIMIT

Banimi, si funksion kryesor i çdo vendbanimi është vendimtar për një stabilitet social, ambient të shëndoshë, shëndet të mirë dhe për një mirëqenie të përgjithshme.

Duke qenë se banimi përfshinë pjesën më të madhe të hapësirës së vendbanimeve dhe është aktiviteti themelor i tyre, ai ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithëmbarshëm të shoqërisë dhe është komponentë e rëndësishme e zhvillimit ekonomiko-social, përkatësisht të standardit jetësor të qytetarëve në përgjithësi.

Shumica e fshatrave në Kosovë asnjëherë nuk janë shquar për infrastrukturë të kompletuar dhe shërbime publike. Ndërsa lufta e fundit në Klinë la pasoja të dukshme edhe në fondin banesor, sidomos në fshatra. Edhe pse lufta ka përfunduar qe 11 vite, pasojat e saj ende nuk janë eliminuar tërësisht. Nevojat për përmirësim të kushteve të banimit, qoftë drejtpërdrejtë në objektet e banimit apo të shërbimeve qe ndikojnë në cilësinë e banimit, janë ende të dukshme, sidomos në zonat rurale.

Nga kjo gjendje nuk bën përjashtim as komuna e Klinës. Ndryshimet dinamike sociale dhe ekonomike të pasluftës e sidomos migrimet drejt zonës urbane janë reflektuar dukshëm edhe në zhvillimin e jo të balancuar të banimit. Deri sa në Klinë si qendër urbane kemi një rritje të numrit të banorëve dhe ndërtimeve, në shumë fshatra paraqitet shpopullimi. Kjo lëvizje e banorëve ka për pasojë uljen e cilësisë së banimit në qytet për shkak të rritjes së numrit të banorëve në raport me shërbimet dhe kapacitetet ekzistuese. Ndërkaq në fshatra vjen deri te mos shfrytëzimi i kapaciteteve të banimit dhe mos investimet në përmirësimin e kushteve te jetesës në to. I tërë ky zhvillim i jo balancuar shkakton pasoja edhe në zhvillim të përgjithshëm social dhe ekonomik të komunës, sidomos nëse merren parasysh potencialet natyrore për zhvillim të bujqësisë dhe blektorisë.

Në përgjithësi, funksioni banimit në komunën e Klinës ka nevojë për investime të mëtutjeshme, sidomos në shërbime të cilat ndikojnë drejtpërdrejtë në cilësinë e banimit.

Që të fitohet një pasqyrë e plotë e cilësisë së banimit në komunën e Klinës, duhet ti kemi vlerësimet e çështjeve tjera si : shkalla e varfërisë, punësimi, arsimimi, infrastruktura, shërbimet publike, shkalla e ndotjes dhe degradimit, shërbimi shëndetësorë, mundësítë për rekreacion etj., e që së bashku tregojnë kualitetin e jetës në këtë komunë.

**Tipi i banimit**—Duke e pasur parasysh se mbi 85% e banorëve të komunës jetojnë në fshatra, tipi dominues i banimit është ai individual. Numri i përgjithshëm i njësive të banimit është mbi 10000, prej të cilave shumica i përkasin banimit individual ndërsa një pjesë e vogël atij shumëbanesor (në zonën urbane).

Tipologja e fshatrave është zhvilluar në varshmëri prej kushteve natyrore e sidomos prej terreneve në të cilat ato shtrihen. Fshatrat e ulëta dhe në afërsi të zonës urbane kanë dendësi e me të lartë në krahasim me fshatrat e karakterit të shpërndarë që shtrihen terrene të pjerrëta veriore, juglindore dhe jugperëndimore. Në përgjithësi, dendësia banimore nepër fshatra, nëse merret parasysh vetëm sipërfaqja e ndërtuar, sillet prej 8 deri në afër 40 banorë / ha.

Ndryshimet ekonomike e sociale të viteve të fundit pasqyrohen edhe në tipologjinë e zhvillimit të fshatrave si vendbanime. Numri i njerëzve që merren me bujqësi apo blektori është në rënje ndërsa ndërtimi në toka bujqësore është në rritje. Në fshatrat në afërsi të zonës urbane dhe përgjatë rrugëve kryesore mund të vërehen tendencat e zhvillimit përgjatë rrugëve, duke tentuar të shfrytëzohet potenciali ekonomik i tyre për ofrimin e shërbimeve të ndryshme, zakonisht në përdhese të shtëpive apo në objekte përcjellëse.

Foto 40. Shtëpi të reja në fshat



Foto 41. Ndërtimet e larta në Klinë



Dendësia banimore në Klinë është rreth 18.2 banorë / ha, nëse merret e tërë zona urbane, përkatësisht rreth 40.3 banorë / ha, nëse merret vetëm sipërfaqja e ndërtuar dhe ajo e transportit. Kjo dendësi është e ulët duke pasur parasysh se kemi të bëjmë me zonë urbane. Kjo dendësi është më e lartë se në zonat rurale por është e ulët për një zonë urbane. Në vitet e pasluftës, si pasojë e migrimit të banorëve nga zonat rurale, është shënuar rritje e numrit të njësive banesore e cila fatkeqësish nuk ka mundur të përcillet më rritjen e kapaciteteve të shërbimeve publike dhe infrastrukturës.

Sipas strukturës së vendbanimeve, përbajtjeve dhe numrit të njësive të banimit, përveç qytetit të Klinës dallohen edhe disa vendbanime tjera si Zllakuqani, Grabanica, Jashanica dhe Ujëmiri. Këto vendbanime kanë tendenca të zhvillimit apo rritjes së mëtejme dhe në të ardhmen do të duhej të mendohej edhe për ngritjen e nivelit të vendbanimit.

**Cilësia e ndërtimit** - Si në tërë Kosovën, lufta e fundit la dëme të shumta në objektet e banimit. Në shumë e fshatra shkatërrimet ishin tejet të mëdha. Pas luftës falë donacioneve por edhe falë angazhimit të vetë banorëve, kjo gjendje u zbut dukshëm kështu që sot shtëpitë e reja përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të fondit të përgjithshëm banesor. Mirëpo nevojat për rindërtim ende nuk janë tejkaluar meqenëse ende ka objekte banimi që si pasojë e luftës, kanë nevojë për sanim apo rindërtim. Me anë të përmirësimit të këtyre objekteve, përveç që do të krijoheshin kushte më optimale për banim, do të kontribuohej edhe në lehtësimin e zonës urbane nga ngarkesa e migrimit.

**Shërbimet** - Cilësia e shërbimeve është një tregues i rëndësishëm i cilësisë së banimit. Nëse merret parasysh niveli i shërbimeve, kapacitetet infrastrukturore, mbulueshmëria hapësinore nga institucionet publike (arsimi, shëndetësia) në Komunën e Klinës, mund të vijmë në përfundim se cilësia e banimit, përkundër investimeve të deritashme, ka nevojë për përmirësimë të m [tutjeshme]. Një pjesë e konsiderueshme e investimeve komunale është orientuar kah përmirësimi i këtyre shërbimeve mirëpo edhe më tutje nevojat janë më të mëdha se sa mundësitetë reale buxhetore.

## OBJEKTET DHE LOKACIONET E TRASHËGIMISË KULTUORE

Treva e Klinës ka reliev të përzier fushorë dhe kodrinorë me mbizotërim të reliefit fushorë. Pozita e favorshme gjeografike dhe kushtet e mira bioekonomike mundësuan jetesën dhe zhvillimin e kulturave të krijimtarisë njerëzore që nga epoka e neolitit kundrejt vazhdimësisë deri në ditët e sotme.


Gjurmimet e para arkeologjike me karakter sistematik janë ndërmarrë në vitin 1978, në fshatin Përçevë, me ç'rast nga 19 kodërvarre të evidencuara 7 sosh janë hulumtuar në tërsi. Në vitin 1983 në ekspeditën përnjohëse të pjesës qendrore të Rrafshit të Dukagjinit u përfshi edhe Jashanica e Epërme, ku u evidencuan vendbanimi shumë shtresorë i epokës parahistorike, një kodërvarr ilir dhe themellet e një kiske mesjetare një nefeshe. Gjatë viteve 1996 – 1991 tehu i gjurmime arkeologjike ka qenë i përqendruar në varrezën ilire të epokës së bronzit të vonë në fshatin Gllarevë, ku janë zbuluar gjithsej 44 varre. Gjatë viteve 1993,1994 në vendbanimin e fortifikuar shumë shtresorë të

fshatit Dollc janë ndërmarrë konservime dhe restaurime të mureve antike dhe të objekteve mesjetare, me ç'rast përfundi shtresave antike janë zbuluar enë fragmentare të epokës së neolitit.

Kërkimet e fundit në komunën e Klinës janë ndërmarrë gjatë vitit 2000. Ato kishin për qëllim sigurimin e të dhënavë elementare lidhur me përfaqësimin e lokaliteteve arkeologjike, skicimin e planimetrisë së vendbanimeve të fortikuara sikurse edhe gjurmimet arkeologjike me karakter sondazhi në Pogradjë.


Në fazën e sotme të gjurmimeve të kufizuara arkeologjike nuk mund të jepet një pasqyrë e plotë e vend zbulimeve arkeologjike, përfaqësimit e shtresimeve në secilin lokalitet veç e veç, mirëpo duke u mbështetur në gërmimet e bëra arkeologjike dhe në rezultatet e përnjohjeve të kohëpaskohshme që janë ndërmarrë në komunën e Klinës mund të jepet një pasqyrë e përgjithshme.

Harta12. Zonat e mbrojtura



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës

Harta13. Tragiwgimia kulturore



## Periudha parahistorike

### a) vendbanimet

Fillet e jetesës në trevën e Klinës datojnë që në periudhën e neolitit. Gjurmë të kësaj periudhe gjemjë në fshatrat **Qupevë e Poshtme, Pogragjë** dhe me gjasë në fshatin **Jashanicë të Epërme**.

Përudhen e neolitit apo përudhen e bakrit e gjemjë të përfaqësuar nga gjetjet e enëve fragmentare të qeramikës, përfundi shtresave të kalasë së antikititetit në fshatin **Dollc**.

Në përudhen e bronzit në ç'kohë formohet etnosi Ilir, në trevën e Klinës njihen disa vendbanime të fortifikuara, të ngritura mbi kodra me pozitë të mirë strategjike. Të kësaj kohe janë vendbanimet kodrinore, të ngritura në **Pogragjë, Jashanicë e Epërme** dhe vendbanimi fushorë në **Rixhevë**. Topogërmadha “**Gradinë**” në fshatin **Dërsnik** nuk le fije dyshimi për ekzistimin e një vendbanimi fushorë, kronologjikisht të pa përcaktuar, të periudhës parahistorike, mbi bërthamën e të cilit do të ngritet vendbanimi i antikititetit.

### b) varrezat

Në fshatin **Gllarevë** janë gjurmuar dy varreza, njëra në vend zbulimin “Rixhevë” e emërtuar Gllareva I dhe tjetra në vend zbulimin “Kërsqi” e emërtuar Gllareva II. Në venzbulimin “Rixhevë” janë gjurmuar 39 varre, ndërsa në vend zbulimin “Kërsqi” janë zbuluar 9 tërësi varresh. Fjala është varreza të tipit të rrafshët nga epoka e bronzit të vonë ( shek. XV – XIII p. Kr.). Në këto varrë të cilat i kanë takuar aristokracisë ilire, janë gjetur armë, stoli etj. të cilat paraqesin fenomen të rrallë shkencor dhe kulturorë për studimin e epokës së bronzit, sikurse edhe lidhjet ekonomike dhe kulturore në mes të aristokracisë vendore të Dardanisë me Mikenen. Ndërsa në **Përçevë** janë evidencuar 19 kodërvarre ilire, nga të cilat në shtatë sosh janë ndërmarrë gjermime arkeologjike. Këto varre sipas gjetjeve të enëve të qeramikës dhe të stolive do t' i kenë takuar periudhës së tranzicionit nga epoka e bronzit në epokën e hekurit ( shek. XIII), fundit të fazës së parë të hekurit ( VI – V p. Kr.), dhe mesjetës së vonë. Në këto varre, në horizontet e varrimit të epokave parahistorike poashtu janë gjetur armë, stoli dhe enë të qeramikës. Veçanërisht shquhen enët e qeramikës, të zbuluar me teknikën e incizimit dhe teknikën e inkrustimit me ngjyrë të bardhë, ku mbizotërojnë motivet e artit gjeometrik.

Gjatë përnjohjes së vitit 1983 në **Jashanicë të Epërme**, rrëzë Gradinës së Roganëve është evidencuar një kodërvarr monumental ilir. Ndërsa gjatë përnjohjeve të vitit 2000 në **Volljakë** janë evidencuar shtatë kodërvarre ilire. Kodërvarret kanë qenë të ndërtuara me gurë dhe pak dhe. Diametri i tyre sillet prej 15 – 30 x 12.5 x 30. Lartësia 70 – 1. 5 m. Ato janë ngritur në një largësi rreth 50 m nga njëra tjetra.

## Periudha e antikititetit

### a) Vendbanimet

Nga periudha e antikititetit të shekujve I – VI në treven e Klinës janë përfaqësuar një varg vendbanimesh si në **Dërsnik, Dollc, Ujmirë, Pogragjë, Siqevë** dhe me gjasë edhe në **Klinë**. Vendbanimet kodrinore të Dollcit dhe të Pogragjës ngriten mbi shtresa të vendbanimeve parahistorike dhe fortifikohen me mure. Tipit të vendbanimeve të fortifikuara kodrinore i takon edhe vendbanimi i Siqevës në “Majen e Zezë” Ndërsa vendbanimi fushorë i Dersnikut sipas monumenteve të shkruara në shek. II gjëzonte statutin e municipit ( qytetit të fortifikuar etj.)

## **Mesjeta**

Epoka mesjetare gjykuar sipas gjetjeve arkeologjike dhe të dhënave historike përfaqësoset në fshatrat **Dollc, Dobërdol, Zabergjë, Cerovikë, Jashanicë të Epërme, Ujmirë, Gjurgjevik, Krushevë, Dërsnik, Klinac, Poterq, Pogradgjë, Klinë, Qabiq, Sverkë e Gashit, Përçevë, Gllarevë, Budisalc dhe Grebenik.**

## **Epoka parahistorike**

### **I. Venbanimet**

#### *1. Pogradgjë*

Në Pogradgjë është identifikuar vendbanimi kodrinor shumështresorë që zë sipërfaqe prej 3 hektarësh. Është përfaqësuar kjo kronologji: periudha e neolitit të mesëm dhe, periudha e bronzit të hershëm. Në antikititin e vonë mbi bërthamën e vendbanimeve parahistorike ngritet vendbanimi i fortifikuar me mure të lidhura me llaç gëlqereje. I takon shek. IV – VI.

#### *2. Gllarevë*

Në topogërmadhen “Rudinë” gjatë gërmimeve arkeologjike janë gjetur fragmente të epokës së bronzit të vonë.

#### *3. Jashanicë e Epërme*

Në vendin e quajtur “Gradina e Roganëve” gjatë përnjohjeve janë gjetur fragmente të qeramikës, të cilat dëshmojnë për ekzistimin e një vendbanimi të epokës IIire të bronzit.

### **II. Varrezat parahistorike**

#### *1. Jashanicë e Epërme*

Rrëzë Gradinës së Roganëve në anën e saj lindore, në Jashanicë të Epërme gjendet një kodërvarre, përkatësisht tumë IIire e periudhës së metaleve, bronzit dhe hekurit.

Kodërvarri në popull njihet me emrin „Kungulla„.

#### *2. Volljakë*

Në Volljakë, në vendin e quajtur „Pllajat e Volljakës“ gjenden 4 kodërvarre ilire të epokës parahistorike. Diametri i tyre sillet prej 15 – 30 x 12.5 – 30 m. Lartësia 0.70 – 1.5 m.

Largësia nga njëra tjetra është rreth 50 m. Ato janë ndërtuar kryesisht me gurë dhe me pak dhe. Ndërsa në vendin e quajtur “Reza” gjenden edhe tre kodërvarre të tjera, të cilat për nga mënyra e ndërtimit dhe përmasat janë të ngjashme me tumat e Pllajës së Volljakës.

#### *3. Gllarevë*

Në vendin e quajtur „Kërrshi„, në të dyja anët e rrugës Prishtinë – Peje, janë gjetur varreza të pasura me stoli dhe armë të epokës IIire të bronzit të mesëm. Varret u kanë takuar aristokracisë së pasur fisnore.

#### *4. Perçevë*

Në vendin e quajtur “Sakra” të Perçevës, janë evidencuar disa kodërvarre ilire të fazës së parë të hekurit. Dy prej tyre janë gërmuar. Në to janë zbuluar varreza të pasura me stoli metali dhe enë të qeramikës.

### **III. Vendbanimet antike**

#### *1. Dërsnik*

*Në fshatin Dërsnik në një sipërfaqe prej disa dhjetra hektarësh janë evidencuar gërmadhat e një vendbanimi.*

Harta14. Lokalitetet arkeologjike




Foto 44. Vendbanim parahistorik



Foto 49. Kodër varrezë



Foto 51. Kishë mesjetare




Foto 50. Kodër varrezë




Foto 43. Planimetri e kështjellës, shek. IV para Krishtit




Foto 45. Mure rrethuese



Foto 47. Fasadë muri, shek IV - VI



Foto 46. Mure rrethuese




Tabela 13. Objektet e trashëgimisë

VENDI	EMËRTIMI	OBJEKTI	PERIUDHA, SHEK., VITI	STATUSI	VËREJTJE
<i>Klina</i>	Ura e gurit	Urë	XVIII		
<i>Gremnik</i>	Azem Merlak	Kullë	XIX-1895		Pjesërisht e rrënuar
	Ukë Maxharaj	Kullë	XIX-1900		
	Ukë Maxharaj	Hambari dhe koshi	XIX		
<i>Qabiq</i>	Ndue Buzhalë	Kullë	XIX-1900		
	Mujë Halil Krasniqi	Kullë	XX	E.K. 247/58	
	Kisha e shën Nikollës	Kishë	XVI		
<i>Ujmirë</i>	Beslim Mustafa	Mulli	XX-1935		
	Bekë Syla	Kullë-shtëpi	XX		
	Bekë Syla	Hambar	XX		
	Shën Pjetri dhe sh. Pali	Kishë	XIII-XIV	E.K.02-245/58	
<i>Grabanicë</i>	Tyrbja e Mustafës	Tyrbe	XVII		
	Kulla e Bardhecëve	Kullë			
	Bajram Berisha	Kullë			
	Idriz Balecit	Kullë	XIX		
<i>Videjë</i>	Dedë Simoni	Kullë	XIX		Pjes. e demtuar
	Zef Shllaku	Kullë	XIX		Pjes. e demtuar
<i>Dollc</i>	Manastiri i Kushtimit të znj. së bekuar	Kishe	XVI	E.K.2-241/58	
	Kryq guri dhe varreza ilire	Varreza			
	Qun Beqa	Kullë	XVIII		Tërsisht e demtuar
	Tomë Beqa	Kullë	XVIII		Tërsisht e demtuar
<i>Rudin</i>	Mehmet Ahmet Xhekaj	Kullë	XIX-1870		
	Ismet Bajraktari	Koshe dhe Hambar	XX		
	Gani Bajraktari	Koshe	XX		
<i>Zllakuqan</i>	Shën Gjoni Pagëzuesit	Kishe	XX-1933		
	Mark Laskaj	Kulle	XX-1932		
<i>Krushevë e vogël</i>	Nikë Gjergji	Kulle	XX-1930		
<i>Zabergjë</i>	Tyrbja e fshatit	Tyrbe	XX		
<i>Doberdoll</i>	Sahit Mata	Kullë	XVIII	Monum i listuar	Pjesërisht
	Kisha Zoja e Berishës	Kishë	XX		
<i>Ranoc</i>	Mark Jaku	Hambari dhe koshi	XX		
	Mark Jaku	Kullë	XX		
<i>Jagodë</i>	Ndrec Gojani	Gardh I thurur			
	Mark Jaku	Kullë	XX		
	Mark Jaku	Hambari dhe koshi	XX		

Tabela 14. Objektet e trashëgimisë - vazhdim

VENDI	EMËRTIMI	OBJEKTI	PERIUDHA, SHEK., VITI	STATUSI	VËREJTJE
<i>Dersnik</i>	Mikel Deda	Hambar misri	XX		
	Kiske varrezore e shën Premtës	Kishë	XIX	E.K. 02-242/58	
<i>Këpuz</i>	Tyrbja e Kpuzit	tyrbe	XX		
	Rexhë Alia	Kullë	XIX		
	Sylë Alia	Kullë	XX		
	Kadri Zeqa	Kullë	XIX		
	Feriz Gjema	Kullë	XX		
	Feriz Gjema	Kullë	XX		
	Hysen Abazi	Kullë	XX		
	Kulla e Lumes	Kullë	XX		
<i>Sverkë</i>	Xhemë Gashi	Kullë	XX		
	Mehmet H. Gashi	Kullë	XX		
	Haxhi Q. Efendia	Kullë	XX		
	Haki Gashi	Kullë	XX		
	Imer S. Gashi	Kullë	XX		
	Fetah S.Gashi	Kullë	XX		
	Beqir B.Gashi	Kullë	XIX		
	Hazir Zeqa	Kullë	XX		
	Zenel Z. Uka	Kullë	XX		
	Azem S. Gashi	Kulle	XX		
	Smajl Gashi	Kullë	XX		
<i>Gjurgjevik i Madh</i>	Isuf Eshref Dushi	Përmendore e familj.	XX		
	Sali Xhokëve	Kullë	XIX		
	Tafil Bajrami	Kullë	XX		
	Sali Xhokëve	Kullë	XIX		
	Sadik R. Gjurgjeviku	Kullë	XVIII		
	Sadik R. Gjurgjeviku	Kullë	XVIII		
<i>Budisalc</i>	Kisha e shën Ndrrimit	Kiske	XIV - XVI	E.K. 87/38	
<i>Pogragjë</i>	Kisha e Epërme	Kishë	XIV-XVI	E.K.02-249/58	
	Kisha e shen Dhimitrit	Kishë	XVI	E.K.02-249/58	
<i>Volljakë</i>	Mbeturinat e kishës	Kishë	XIV	E.K.513/66	
	Salih Zenuni	Kullë	XIX	listuar	
<i>Paskalicë</i>	Kisha e fshatit	Kishë	XIII	E.K.520/66	

Burimi: Instituti për Mbrojtjen e Monumenteve, Prishtinë

## ZONAT E VEÇANTA TË MBROJTURA

Zonë e veçantë e mbrojtur është një zonë e përcaktuar që rrrethon një monument, ndërtesë, grup ndërtesash, tërësi, fshat ose qendër historike të qyteteve që mbrohet nga çdo zhvillimi apo aktivitet i cili mund të dëmtojë kontekstin e tij historic, kulturor, arkitektonik apo arkeologjik, mjedisin natyror apo kuadirlor visual estetik.

Në komunën e Klinës gjenden tri zona të veçanta të mbrojtura: Manastiri I Budisalcit, Manastiri I Dollcit dhe Kisha e Heremitëve në Ularicë.

**MANASTIRI I BUDISALCIT**– monumenti dhe lokacioni është në gjendje ralativisht të mirë. Ekszistojne disa dëmtime të vogla për shkak të mungesës së mirëmbatjejs si dhe propozohet të bëhet konservimi i fresakave. Sa i përket sigurisë dhe monitorimit ajo është e sigruar nga PK-ja që nga nëntori i vitit 2012. (*burimi: Raporti i progresit “Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë”, 2009 ICO, fq 33*)



Fig.x. Manastiri I Budisalcit, Budisalc..

MANASTIRI I DOLLCIT – monumenti është i shkaltëruar, lokacioni i brakstisur dhe i rrezikuar nga zgjerimi i mundshëm i rrugës. Zona nuk është e siguruar dhe ka qasje të pakontrolluar.

( burimi: Raporti i progresit “ Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë”, 2009 ICO, fq 34)



Fig.x. Manastiri I Dollcit, Dollc.

HERMITAZHI ME KISHË APO KISHA E HEREMITËVE –freskat në kishën e vetmitarëve janë në gjendje të keqe. Zona e veçantë e mbrojtur është shkulur nga ndërtimi i një rrugë të re (të paasfaltuar) me parkim dhe ndërtim të jashtëligjshëm dhe nga ndërtimi i një mini hidrocentrali. Zona nuk është e siguruar dhe qasja është e pakotrolluar.

( burimi: Raporti i progresit “ Vënja në jetë e zonave të veçanta të mbrojtura për trashëgiminë fetare dhe kulturore në Kosovë”, 2009 ICO, fq 34)




Fig.x. Hermitazhi me kishrw– Kisha e heremitwve, Ularicw.

## INFRASTRUKTURA

Infrastruktura teknike në komunën e Klinës, si dhe shërbimet publike të ndërlidhura me te, kanë nevojë për përmirësimë dhe investime të mëtutjeshme, ngashëm si në pjesën më të madhe të Kosovës. Përkundër faktit se Kлина ёshtë një ndër komunat më të pasura me rrjedha ujore, uji i pijshëm end e paraqitet si problem i pazgjidhur në tërsi. Sa i përket rrjetit të kanalizimit, përkundër investimeve të deritashme, ka nevojë për shtrierjen e mëtutjeshme të tij dhe përmirësimin dhe kompletimin e rrjetit ekzistues. Furnizimi me energji kërkon investime të m [tutjeshme, me qëllim të rritjes së kapaciteteve. Rrjeti rrugor ёshtë përmirësuar në vazhdimësi pas luftës, por mbetet ende për tu bërë, sidomos në brendi të disa vendbanimeve, si dhe në plotësimin e profileve rrugore, me qëllim të rritjes së sigurisë.

## TRAFIKU DHE TRANSPORTI

Pozita natyrore dhe topografia mundëson që Kлина të ketë lidhje të mira rrugore dhe hekurudhore. Nëpër Klinë kalon magjistralja Prishtinë-Pejë e cila ka rëndësi të veçantë në nivel të Kosovës. Në Klinë gjithashtu gjendet nyja hekurudhore e cila rangohet si e dyta me rëndësi për territorin e Kosovës, pas nyjes hekurudhore në Fushë Kosovë.


**Trafiku dhe transporti rrugor** - Rrjeti rrugor përbëhet prej rrugëve që kategorizohen në magjistrale, regionale dhe lokale. Rruga magjistrale dhe ato regionale paraqesin vijat kryesore të qarkullimit dhe lidhjeve brenda komunës dhe në pjesën më të madhe shtrihen në terrene të rrafshëta apo përgjatë luginave. Ndërkaq, rrugët lokale kanë një shtrierje të lirë në mes vendbanimeve, duke iu përshtatur kushteve natyrore që ofron hapësira e Klinës.

Magjistralja Prishtinë - Pejë paraqet arterien kryesore të qarkullimit rrugor, që në territorin e komunës shtrihet kryesisht në drejtimin lindje-perëndim, duke e ndarë ate në dy tërsi. Kjo magjistrale mundëson lidhje me pjesët qëndrore dhe lindorë të Kosovës, duke e përfshirë edhe kryeqytetin, ndërsa përmes degëzimeve të mëtutjeshme mundëson lidhje me shtetet fqinje, Maqedoninë dhe Serbinë. Në drejtimin perëndimor, magjistralja mundëson lidhje me Pejën si qendër regionale, si dhe me Malin e Zi në vazhdim. Në të ardhmen, kjo magjistrale do të mundësojë edhe lidhjen me autostradën Durrës - Merdarë, në drejtimin verilindor.

Përveç në segmentin në mes fshatrave Gllarevë dhe Dollc, ku magjistralja kalon nëpër pjesë kodrinore, në pjesët tjera kjo rrugë shtrihet në terren kryesisht të rrafshët. Pozita e Klinës, si qendër komunale, në raport me rrugën magjistrale ёshtë e përshtatshme, duke qenë se pjesa qendrore e qytetit ёshtë rreth 2.5 km larg saj, që mundëson një lidhje të shpejtë por njëkohësisht diskrete, larg ndikimive nga trafiku i nivitet të lartë. Në pjesën perëndimore, përgjatë Lumbardhit të Pejës, vendbanimet përgjatë kësaj magjistraleje janë më të shpeshta, që kërkon kujdes dhe kufizim të shpejtësisë së qarkullimit.

Rruga regionale për Gjakovë kryqëzohet me rrugën magjistrale rreth 620 m në lindje të kryqëzimit për qytetin e Klinës dhe ёshtë lidhja më frekuente në krahasim me drejtimet tjera regionale brenda komunës. Shtrihet kryesisht në drejtimin veri - jug, përgjatë rrjedhës së Drinit të Bardhë dhe pothuajse paralel me drejtimin hekurudhor për Prizren. Kjo rrugë regionale mundëson lidhjen e Klinës me Gjakovën dhe Prizrenin, si dhe në vazhdim lidhjen me Shqipëri.

Harta 15. Rrjeti rrugor dhe hekurudhor



Në të ardhmen, kjo rrugë regionale do të mundësojë edhe lidhjen me autostradën Durrës - Merdarë, në drejtimin jugor. Sa i përket zhvillimit të planifikuar të rrjetit rrugor brenda komunës, është paraparë që kryqëzimit për Gjakovë ti shtohet edhe drejtimi nga veriu, ku do të mundësohet qëkjo rrugë regionale të vazhdohet edhe në veri të magjistrales, me ç'rast do të krijohet një drejtim tranzit i cili shtrihet në lindje të qytetit të Klinës dhe kyçet në rrugën regionale për Skenderaj, rreth 1 km në lindje të zonës industriale.

Në pjesën veriore, deri në fshatin Qypovë, rruga regionale për Gjakovë shtrihet në terren të rrafshët, duke qenë se këtë e mundëson hapësira e gjërë luginës së Drinit të Bardhë dhe venderdhjes së Lubardhit të Pejës. Në jug të Qypovës lugina e Drinit të Bardhë ngushtohet duke bërë që shtrirja e kësaj rruge të jetë përgjatë skajit lindor të saj, rrëzë terreneve kodrinore.

**Rruga regionale për Istog** lidhet me rrugën magjistrale përmes zonës urbane të Klinës. Në pjesën më të madhe ka shtrirje në drejtim veriperëndimor, përgjatë rrjedhës së Lumbardhit të Pejës dhe Lumit të Istogut. Për shkak se shtrihet në terren të rrafshët dhe të përshtashëm për banim, përgjatë kësaj rruge shtrihen disa vendbanime si dhe qasje nga to, për ç'shkak është i nevojsh[m kufizimi i shpejtësisë në pjesë të caktuara.

**Rruga regionale për Skenderaj**, lidhet me rrugën magjistrale përmes zonës urbane të Klinës, ky kryqëzohet me rrugën nga Istogu. Kjo rrugë mundëson lidjne me Skenderajin, Mitrovicën dhe me pjesët tjera të veriut të Kosovës. Në pjesën më të madhe shtrihet përgjatë terreneve kodrinore, kryesisht në drejtim verilindor.

Drejtimet kryesore rrugore brenda qytetit të Klinës - pozita qendrore e qytetit të Klinës në raport me drejtimet rrugore të komunës, por edhe më gjerë, ka kushtëzuar që drejtimet kryesore të qarkullimit brenda komunës të kalojnë përmes saj, apo në afërsi të saj. Kjo ka shkaktuar që në periudha të caktuara të krijojen ngarkesa të trafikut brenda në qytet, gjë që ka ndikime negative ambientale dhe funksionale. Kjo ka të bëjë sidomos me drejtimet për Istog dhe Skenderaj. Këto dy drejtime rrugore bashkohen mu në qendër të Klinës, përmes një rrethrrrotullimi kapaciteti i të cilit nuk është gjithmonë i mjaftueshëm për ta pranuar tërë trafikun tranzit dhe atë të qytetit. Bashkimi i e këtyre dy drejtimeve dhe vazhdimi deri në rrugën magjistrale është poashtu problematik, sidomos në pjesën qendrore të qytetit në veri të lumit Klina, duke qenë se përgjatë këtij segmenti rrugor zhvillohen edhe një numër i madh i përbajtjeve të qytetit, të cilat po ashtu joshin trafik.

Element tjetër që ndikon në ngarkesat e trafikut janë edhe kryqëzimet i drejtimeve rrugore për Istog dhe për Skenderaj, me drejtimin hekurudhor Klinë - Pejë. Të dy këto kryqëzime janë brenda hapësirës së qytetit, duke shkaktuar kolona të pritjes gjatë kalimit të trenit në relacionin Prishtinë - Pejë dhe anasjelltas.

Në kuadër të planeve për zhvillimin e rrjetit rrugor brenda komunës, është paraparë edhe ndërtimi i transitit që e lidh udhëkryqin e Gjakovës me rrugën regionale për Skenderaj. Ky transit është planifikuar të shtrihet përmes fushës së Dërsnikut, në drejtimin veri-jug, ndërsa në rrugën regionale për Skenderaj do të kyçet rreth një kilometër në lindje të zonës industriale. Përmes këtij transiti do të mundësohet që trafiku nga drejtimi i Pejës, Gjakovës dhe pjesa lindore e komunës që për cak ka Skenderajin, ti shmanget zonës urbane.

Në planet e ardhme është e nevojshme që të trajtohet dhe zgjidhet edhe trafiku transit që përsnim e ka drejtimin e Istogut.

Foto 53. Rruga magjistrale Prishtinë - Pejë dhe kyçja e rrugës regjio nale të Gjakovës



Foto 54. Rruga magjistrale Prishtinë - Pejë nëpër Zllakuqan, me trotoar në njerën anë



Foto 55. Rruga në Përqevë - shembull i rrugës së fshatit pa trotoar



Foto 56. Kryqëzimi i hekurudhës Klinë - Pejë me rrugën Klinë - Istog



Foto 57. Kryqëzimi i pambrojtur i hekurudhës  
Klinë - Pejë me rrugën e fshatit Jagodë



Rrugët lokale përbëjnë kategorinë më të ulët në hierarkinë e rrugëve në komunë, por që ka shpërndarjen më të gjerë, meqenëse i lidhin fshatrat në mes veti. Rrjeti i rrugëve lokale është më i dendur përgjatë drejtimeve kryesore rrugore si dhe përgjatë luginave, duke qenës se në këto hapësira janë të përqendruara vendbanimet.

Gjendja e rrugëve lokale është dukshëm më e mirë në krahasim me vitet e para të pasluftës, dhe sot pjesa më e madhe e rrugëve që lidhin fshatrat tashmë është e asfaltuar. Një pjes[ e këtyre rrugëve mbetet edhe më tutje e paasfaltuar, me zhavorr ose dhe, ndërsa ka nevojë për shtruarje të rrugëve edhe në brendi të vendbanimeve. Po ashtu, në pjesë të caktuara të cilat shfrytëzohen nga nxënësit, është i nevojshëm plotësimi i profileve rrugore, me trotuare dhe mburoja.

**Trafiku dhe transporti hekurudhor** - Përveç lidhjeve të mira rrugore, Kлина ka lidhje të mira edhe përmes hekurudhës, duke qenë se në Klinë gjendet nyja e dytë hekurudhore e Kosovës, pas asaj në Fushë Kosovë. Në këtë nyje degëzohen drejtimet për Pejë dhe Prizren të cilat përmes Klinës lidhen me Fushe Kosovën për t'u degëzuar më tej për Shkup, Nish apo Beograd. Fatkeqësisht drejtimet hekurudhore paraqesin një potencial ende të pashfrytëzuar duke pasur parasysh qarkullimin minimal të trenave në hekurudhat e Kosovës.

Momentalisht është në qarkullim lidhja Prishtinë - Pejë, i cili kalon dy herë në ditë në secilin kah, duke u ndalur edhe në Klinë. Për terminal të udhëtarëve shfrytëzohet ndërtesa e ndërtuar gjatë viteve të tridhjeta të shekullit të kaluar, si në shumë pika tjera në Kosovë. Linja për Prizren shfrytëzohet rrallë, kryesisht për transport të lëndës së parë.

**Transporti i udhëtarëve** - Për shkak të funksionimit tejet të ulët të komunikacionit hekurudhor, pothuaj se i tërë transporti i udhëtarëve bëhet me autobusë. Edhe pse Klinë karakterizohet me lidhje të mira rrugore, transporti i udhëtarëve në Klinë ballafaqohet me mungesa të mëdha suprastrukturore dhe organizative. Përkundër faktit se qyteti i Klinës është qendër komunale, asaj ende i mungon një stacion i autobusëve apo së paku një pikë e veçantë në të cilën do të bëheshin ndaljet dhe nisjet e organzuara të autobusëve. Ndërtesa e paraparë për stacion të autobusëve nuk ka funksionuar asnjëherë si e tillë, ndërsa para disa viteve në vend të saj është ndërtuar stacioni policor. Si pasojë e kësaj mungese, ndaljet e autobusëve bëhen nëpër shumë pika nëpër qytet ose jashtë tij. Kjo mënyrë e shpërndarë e zhvillimit të transportit të udhëtarëve është tejet jofunkSIONALE dhe shkakton pengesa në zhvillimin e komunikacionit.

Shikuar në përgjithësi, lidhjet rrugore dhe hekurudhore bëjnë që Kлина të jetë një nyje e rëndësishme e trafikut për vendbanimet në jug dhe perëndim të Kosovës. Është me rëndësi që këto potenciale të shfrytëzohen për një zhvillim të qëndrueshëm të komunës, por me sa më pak ndikime negative në mijdis, si dhe në funksionet urbane dhe të banimit.

## EKONOMIA UJORE DHE INFRASTRUKTURA HIDROTEKNIKE

### 1. Ekonomia ujore dhe rrjedhat:



**Lumi Drini i Bardhë** është lumi kryesor i Rrafshit të Dukagjinit. Sipërfaqja e pellgut të këtij lumi është  $S=4.360 \text{ km}^3$  apo rreth 42.63% të sipërfaqes së tërësishte të Kosovës dhe me rrjedhje vjetore  $2.200 \times 10^9 \text{ m}^3$  ose 61.0%.

Banorët e kësaj treve ujin e këtij lumi i përdorin për shumë qëllimi si për: energji elektrike, furnizim me ujë të pijës etj, por më së shumti e përdorin për ujitjen e tokave. Reshjet mesatare në pellgun e të lumbit është 890mm.



**Lumi Klina** është degë e majtë e lumbit Drini i Bardhë. Sipërfaqja e pellgut të këtij lumi është  $S=423 \text{ km}^3$  apo rreth 10.0% të sipërfaqes së tërësishte të lumbit Drini i Bardhë, me koeficient të rrjedhes  $4.92 \text{ l/s/km}^2$  dhe reshje mesatare 702mm.

Sa i përketë vërvshimeve, probleme të mëdha ka patur nga lumi Klina, por me rregullimin ei shtratit të lumbit qyteti i Klinës më nuk ka patur probleme. Rregullimi i shtratit është nga derdhja në Dri deri te burimi i Jarinës, gjegjësisht, deri te ngushtimi natyral i lumbit (gryka). Profili i rregulluar është trapez i dyfishtë me shtrat minor dhe major me gjëresi 36.00 dhe thelli 3.1m ndërsa i pranon ujërat maximale 100 vjeqare.

Gjendje momentale e shtratit të lumbit është në gjendje të mjerueshme. Në shtratin minor janë hudhur mbeturina të ndryshme (material ndërtimor, makina të vjetra, etj) të cilat pengojnë rrjedhjen e natyrshme të ujit në te dhe janë rezik permanent për vërvshime dhe ndotje të ujit.

Lumë tjetër me rëndësishëm në komunën e Klinës është:

**Lumi Bistrica e Pejës** që është degë e djathtë e lumbit Drini i Bardhë që derdhet në Dri të Badhë në afërsi të Zjamit. Ky lumw kalon nwpwr vendbanimet Petriq i Poshtwm, Dugajevw, Grabanicw dhe Zajm.

**Lumi Bistrica e Deçanit** që është degë e djathtë e lumbit Drini i Bardhë që derdhet në Dri të Badhë në afërsi të Gremnikut. Rrjedhja e këtij lumi kalon mw nw kufirin e Komunws sw Pejws dhe tw Klinws

**Lumi Mirusha-** dega e majtë e lumbit Dri i Bardhë. Rrjedhja e këtij lumi kalon mw nw kufirin e Komunws sw Pejws dhe tw Klinws dhe njw pjesw e vogël kalon nwpwr Komunwn e Klinws

**Lumi Istog-** dega e majtë e lumbit Dri i Bardhë. Ky lumw ka njw gjatwsi tw voglw nwpwr komunwn e Klinws dhe derdhja e tij bwhet nw komunwn e Klinws.

Lumenjtë e vegjël si lumi i Jashanicë, lumi i Renocit, proi i Volujakës, etj janë lumenj me tipare karakteristike për përrokskat malore, që dmth lumenj të vegjël, me oscilime shumë të mëdha të sasisë së ujit gjatë vitin.

Gjatë kohës së thatë në shumicën e këtyre lumenjve ka shumë pak ujë ose nuk ka ujë fare, kurse gjatë kohës me reshje shpesh ndodh që të ketë vërvshime lokale.

## **2. Furnizimi me ujë të pijshëm.**

Një ndër problemet më të mëdha të Komunës së Klinës është furnizimi i banorëve me ujë të pijshëm. Këto probleme janë për arsyen se shumica e vendbanimeve nuk furnizohen me ujë nga sistemet e ujësjellësit, por nga puset dhe burime të pakontrolluar. Probleme kanë edhe banorët që kanë rrjetin ujësjellësit përshka të cilësisë diskutabile të ujit.

### **2.1 Furnizimi me ujë i fshatrave**

Furnizimi i vendbanimeve të komunës së Klinës bëhet nga:

- rrjeti i qytetit,
- sistemi i Jashanicës, që është i lidhur në rrjetin ujësjellësit të qytetit dhe
- nga sistemit vetjake të vendbanimeve.

Pjesa tjetër e vendbanimeve furnizohen me ujë ashtu siç mundem dhe dinë: nga puset individuale, burime individuale etj. Këto burime janë të pa kontrolluar dhe shpesh të ndotura dhe me sasi të pamjaftueshme të ujit.


Familjet që furnizohen me ujë nga puset kanë probleme të mëdha me cilësinë e ujit e sidomos gjatë reshjeve kur uji ka mundësi të kontaminohet.


Pra siç shihet nga tabela mw poshtë vetëm 24 ose 44.44% të vendbanimeve kanë ujë të pijes nga sistemi i ujësjellësit, kurse 30 ose 55.55% të vendbanimeve furnizimi me ujë të pijes e bëjnë në mënyrë individuale secila familje e bënë furnizim në mënyrën e vetë qoftë nga puset, burimet etj.

Vendbanimet të cilat janë të lidhur në sistemin qendror të qytetit që janë 15 ose 27.77%. Siç dihet problem i madh për këta banorë është se cilësia e ujit është shumë diskutabile. Prandaj banorët nuk e shfrytëzojnë këtë ujë për pije.

Sistemi i ujësjellësit Sferkë ka probleme teknike, prandaj mund të themi se nuk është në funksion.

Tek sistemet e ujësjelëlti në Qeskovë, Kpuz dhe Grabanicë ka probleme me sasinë e ujit sidomos gjatë stinës së verës.





Vendbanimet me sistem të ujësjellësit:

Zyra e vendit		VENBANIMI	MENYRA E FURNIZIMIT ME UJE	LLOJI I SISTEMIT
1.Klinë	1	Klina	Sistemi i ujësjellësi të qytetit	Nga rezervuari në i vjetër
	2	Dollc		
	3	Dresnik		
2.Jashanicë	1	Jashanica	Sistemi i ujësjellësi në Jashanicë	Nga rezervuari i ri
	2	Pograxha		
	3	Jelloci		
	4	Dushku		
	5	Ujmiri		
	6	Siqeva		
	7	Shtupel		
	8	Kërnicë		
	9	Bingjë		
	10	Grapc		
	11	Dranashiq		
	12	Klinafc		
3.Sferkë	1	Sferkë	Sistemi i ujësjellësi i Sferkë	Nga pusi me pompa
	2	Dush		Nga pusi me pompa
	3	Voljakë		Nga pusi me pompa
	4	Oypevë		Nga pusi me pompa
4. Furnizim nga burimet vetjake	1	Bërkovë		
	2	Qeskovë		
	3	Kpuz		
	4	Grabnicë		
	5	Gremnik		
Furnizim individual	1	Zajm	Furnizim individuale (secila nga familjet kanë patur furnizim vetjak)	Nga puset, burimet etj
	2	Videjë		
	3	Deiq		
	4	Krushevë e Vogël		
	5	Gjurgjevik i Vogël		
	7	Jagodë		
	8	Budisalc		
	9	Rudicë		
	10	Krushevë e Madhe		
	11	Stupë		
	12	Nagllavë		
	13	Zllakuqan		
	14	Ranoc		
	15	Laskoc		
	17	Radulloc		
	18	Drenoc		
	19	Dubajevë		
	20	Pjetérq i Poshtem		
	21	Pjetérq i Epërm		
	22	Bokshiq		
	23	Dollovë		
	24	Resnik		
	25	Gjurgjevik i Madh		
	26	Çabiq		
	27	Dobérdoll		
	28	Gllarevë		
	29	Rixhevë		
	30	Caravik		
	31	Zabërgjë		

### **3. Rrjeti i kanalizimit**

#### **3.1 Rrjeti i kanalizimit në fshatra**

Vetëm 8 vendbanime të komunës së Klinës kanë rrjet të kanalizimit fekale:

1. Gremniku
2. Drenoci
3. Dushku
4. Çabiqi
5. Gllareva
6. Rixheva
7. Caraviku
8. Zabërgjë

Gremniku, Drenoci dhe Dushku kanë sistem të veçanta të kanalizimit, kurse Çabiqi, Gllavera, Rixheva, Caraviku dhe Zabërgjë janë në të njëjtin sistem të kanalizimit.

Të gjitha këto vendbanimet ujërat e zeza i shkarkojnë në lumenjtë më të afërt pa ndonjë trajtim paraprakë. Pra, janë ndotës të drejtpërdrejt të lumeneve.

Në fshatrat tjërë ku nuk ka rrjet të kanalizimit, banorët shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë numër gropë klasike, nëpër jaze ose kanale sipërfaqësore, kurse shtëpitë ose grup shtëpisë që kanë afër lumenj shkarkimin e ujërave të zeza e bëjnë drejtpërdrejt në lumë pa ndonjë trajtim paraprak.

Si në çdo vendbanim të Kosovës edhe në Komunën e Klinës ndotja e ujit është evidente. Ndotja më e madhe paraqitet e lumenjeve bëhet përmes lëshimit të drejtpërdrejt të ujërave të zeza të vendbanimeve dhe të objekteve industriale, pa ndonjë trajtim paraprak. Gjithashtu hedhja e mbeturinat të ngurta pranë rrugëve dhe lumenjeve përbën një problem të madh.

## RRJETI ELEKTROENERGJETIK DHE TELEKOMUNIKUES

Klina me rrethinë aktualisht përballet me vështirsi të shumta në furnizimin kontinuel dhe kualitativ të konsumatorve me energji elektrike. Që të vërehen shkaqet do të përshkruajmë gjendjen aktuale këtu, në të gjitha nivelet e tensionit.

Aktualisht qyteti i Klinës me rrethinë furnizohet nga trafostacioni TS Klina 110/10(20) kV/kV, me fuqi instaluese 31,5 MVA. Ky trafacion furnizohet në formë unazore nga TS Gjakova II dhe TS Peja 3, me këtë është plotësuar kushti i kërkuar sipas standardeve Europiane N-1 dhe problemet që Klina i kishte në furnizim nga rrjeti radial përmes vetëm një linjë ajrore 110 kV-she është eliminuar.

Egziston mundësia e furnizimit të këtij qyteti edhe me linjën 35 kV-she nga Gurakoci, përmes trafostacionit TS Klina 35/10 kV/kV, me fuqi instaluese 2x4MVA, mirëpo nuk ka nevojë, sepse rrjeti 35kV gradualisht do të shuhet si dhe për shkak të problemeve me fytet e ngushta në rrjetin distributiv në Distriktin e Pejës (Klina është njësi e Pejës), është eliminuar mundësia e furnizimit në nivelin 35 kV, pra nga TS Klina 35/10 kV/kV

Ngarkesa maksimale e apsorbuar arrin vlerën 17.06 MË. Pra mund të konstatohet se konsumi i arritur i pjesës urbane me pjesën rurale është 17,062 MVA Shihet nga kjo se mundësia transformuese në nivelin 110 kV tejkalon vlerën e konsumit maksimal të Klinës, ndërsa në nivelin 35 kV mund të furnizohet vetëm 54% e këtij konsumi.

Linjat furnizuese të tensionit të mesëm janë të dimensionuara për nivelin 10 kV. Këto linja kryesisht janë ajrore, dhe të montuara në shtylla të impregnuara të drurit (SHD), në shtylla të betonit (SHB), e në disa ekziston kombinim i tyre (SHBD).


Njësitë transformuese janë kryesisht të montuara në shtyllë metalike TSM dhe të montuara në shtyllë betoni TS B. Gjendja teknike e këtyre objekteve në tërësi nuk është e mirë, nga fakti se shumica e tyre janë të vjetësuara dhe të mirëmbajtura jo si duhet.

Në shtojcën e këtij përshkrimi është dhënë situacioni i linjave dhe trafostacioneve që furnizojnë fshatrat e komunës së Klinës.

Mund të konstatohet se krijimi i rrjetit shpërndarës furnizues këtu është realizuar pa ndonjë analizë, sidomos në aspektin e optimizimit. Problem poashtu të theksuar paraqesin seksionet jo adekuate të përquesve të linjave 10 kV-she në raport me gjatësitë e tyre dhe nr. eTS-ve të kyqura në to.

Pjesa e telekomunikacionit është e kufizuar në 2000 lidhje të inkorporuara në një central të tipit SI 2000. Nga kjo sasi fare pak janë distribuar në pjesën rurale. Rrjeti shpërndarës është ajror. Trasë të veqant ka diku rreth 60% të rrjetit egzistues telefonik, ndërsa pjesa tjeter shfrytëzon rrjetin distributiv.

Harta18. Rrjeti elektroenergetik dhe telekomunikues






## MJEDISI NATYROR

### KARAKTERISTIKAT RAJONALE

Sipas Planit Hapësinor të Kosovës, Komuna e Klinës bën pjesë në rajonin e emërtuar si Hapësira e verdheë, e cila zë pjesën perëndimore dhe veriperëndimore të Kosovës, shtrihet në luginën e pëlleshme të Dukagjinit, përgjatë kufirit me Bjeshkët e Nemuna, në luginën e Lumëbardhit, me afro 300.000 banorë, klimë kontinentale e klimë mesdhetare dhe me një rrjet hidrografie të zhvilluar. Komunat që e përbëjnë këtë zonë janë: Peja, Istogu dhe Kлина. Hapësira karakterizohet me mjedis të pastër, pyje dhe tokë kualitative bujqësore, rezerva të ujërave termal, thëngjillit në afërsi të Klinës, trashëgimi të pasur natyrore dhe kulturore, si dhe një traditë në kultivim të agro-industrisë, tregtisë dhe turizmit. Një pjesë e madhe e monumenteve natyrore të kësaj hapësire janë të përqendruara në Komunën e Klinës:

- **Burimi i ujit mineral** në Dresnik, Klinë – monument natyrore me karakter hidrologjik;
- **Gryka e lumit Kлина**, Klinë – monument i natyrës me vlera gjeomorfologjike, hidrologjike dhe botanike
- **Trungu i qarrit** në Zllakuqan, Klinë – monument natyrore me karakter botanik dhe turistik.
- **Trungu I rrwnjws** nw Deiq- monument natyrore me karakter botanic
- **Komplesi I trungjeve tw rrwnjws** nw Gllarevw- monument natyrore me karakter botanic
- **Trungu I qarrit** nw Nagllavkw- monument natyrore me karakter botanic
- **Burimi I ujit mineral** nw Rudicw- monument natyre me karakter hidrologjik
- **Trungu I bungut** nw Ujwmirw- monument natyre me karakter botanic
- **Trungu i qarrit** në Poterq të ulët, Klinë – ish monument natyrore me karakter botanik;
- **Trungu i qarrit** në Bërkovë, Klinë - ish monument natyrore me karakter botanik
- **Parku rajonal i Mirushës**, Klinë, Malishevë, Rahovec – Kanioni, ujëvaret dhe peizazhet specifike, një fenomen natyrore me rëndësi të jashtëzakonshme


Burimi: Agjencioni pwr mbrojtjen e mjedisit tw Kosovws “Gjendja e natyrws- rapport 2008-2009”, Prishtinw 2010, fq. 39-43)



Burimi: Plani Hapësinor i Kosovës

Harta 19. Zonat dhe monumentet e mbrojtura (burimi :Pkani Hapësinor i Kosovës)

#### Harta20. Zonat dhe monumentet e mbrojtura natyrore



## KARAKTERISTIKAT GJEOMORFOLOGJIKE TE KLINËS

Territori i komunës se Klinës ka karakteristika të ndryshme gjeomorfolologjike. Pjesa lindore ka karakter të lartësisë ndërsa pjesa perëndimore ka karakter të rrafshët. Pjesa veriore dhe verilindore e komunës është e përbërë prej viseve malore të Prekorupës dhe Drenicës ndërsa pjesa perëndimore dhe pjesa qendrore janë pjesë e rrafshinës së Rrafshit te Dukagjinit. Pjesët te cilat i përkasin Rrafshit te Dukagjinit janë ne zonen me lartësi mbidetare deri ne 500 m, ndërsa pjeset kodrrinore gjenden kryesisht në lartësinë ndërmjet 500 dhe 700 m. Ne pjesën lindore, një pjesë vogel e territorit te kësaj komune ka lartesinë pak më të madhe se 700 m.

Toka e kësaj komune është kryesisht e përbërë nga mergeli dhe argilli me thëngjill. Pjesa qendrore dhe lindore është përbërë nga flishi i shkrepjes se lartë mastrihitik-denonsik, një pjesë e vogël është nën serpentinë dhe perioda serpentine si dhe ka senon të pandarë.

Terrenet në të cilat është locuar vendbanimi i Klinës, morfologjikisht janë të rrafshta dhe shumë të papërshtatshme për zhvillim të mëtutjeshëm hapësinor. Pjesa më e madhe e vendbanimit është e rrafshët nga pjesa e majtë e Drinit të Bardhë, në lartësinë mbidetare prej 385 deri 390 m. Një pjesë e terrenit në afërsi të drejtimit hekurrudhor për Pejë është e nënshtuar ndaj rrëshqitjeve. Pjesët e vendbanimit në veri të binareve te hekurudhës gjenden ne pjesë me rënie të lehte në një lartësi mbidetare 400-420 m.

Terrenet të cilat shtrihen në veri të hekurudhës dhe në veri të vendbanimit kanë eksposicion jugore, ndërsa pjesa më e madhe është në zonën e rrafshinës dhe ka eksposicion veriperëndimor.

Rëniet e terrenit në Klinë janë prej  $10-15^{\circ}$ . Lugina e rrafshit në te cilën është locuar pjesa më e madhe e vendbanimit është përbërë nga mergeli, argilli me thëngjill, bartjet e vërshimeve, ranoret dhe grumbujt e rërës. Pjesa nga veriu është e vjetërisë Pliocene dhe është e përbërë nga zhavoret, rëra dhe argilli i terases së liqejeve.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## KARAKTERISTIKAT KLIMATIKE

### RRJEDHA VJETORE E TEMPERATURËS SË AJRIT

Temperatura mesatare e ajrit ne Klinë është  $10.8^{\circ}\text{C}$ . Në korrik arrihet temperatura maksimale absolute prej  $37.6^{\circ}\text{C}$  ndërsa ne shkurt temperatura minimale absolute prej  $-11.8^{\circ}\text{C}$ . Amplituda mesatare është  $46.1^{\circ}\text{C}$ .

Tabela 15 . Rjedha mesatare maksimale dhe minimale e temperaturave të ajrit në Klinë është :

Muajtë	temp.mesatare	Ampl.max	Ampl.min	Amplitudat
janar	-1.1	12	-9.6	21.6
shkurt	0.1	11.5	-11.8	23.3
mars	7.9	24.3	-8.2	32.5
prill	11.3	27.5	-1.8	23.3
maj	16.2	28.5	3.2	31.5
qershor	18.3	33	8.9	41.9
korrik	21.1	37	9.1	46.1
gusht	19.7	32.7	9.7	42.4
shtator	18.5	31.5	5.8	37.3
tetor	10.7	29.3	-1.8	31.1
nëntor	5.1	20.5	-9.2	29.7
dhjetor	0.9	13.5	-8.2	21.7
vjetore	<b>10.8</b>	<b>37</b>	<b>-11.8</b>	<b>46.1</b>

## INSOLIMI

Mesatarja vjetore e orëve të insolimit në Klinë nuk është matur mirëpo orientimisht mund të merren të dhënrat për Pejë, për arsyet e afersisë së tyre dhe orientimit gati identik të terrenit.

Tabela 16. Insolimi - Numri i orëve

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Pejë	105.9	129.4	144.5	206.1	176.4	204.8	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	257.2	213.6	255	143.1	55	842	1973.2

Tabela 17 . Vranësirat - Rrjedha vjetore e vranësirave

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Klina	5.9	5.1	5.6	5.1	6.1	5.8	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	4.7	5.3	2.9	5.5	7.6	6.2	5.5

Vranësira mesatare më e vogël për Klinë për muajin nëntor është 2.9 ndërsa mesatare vjetore është 5.5 të dhjetat e qielosit në Klinë.

Tabela 18. Të reshurat - Lartësitetë mujore e të reshurave

Lokaliteti	I	II	III	IV	V	VI	
Klina	12	4	38	45	40	60	
	VII	VIII	IX	X	XI	XII	Vjet
	18	48	16	143	73	42	540

Vlera mesatare vjetore e të reshurave në Klinë është 540.0mm, të reshurat më të mëdha janë në muajin tetor ndërsa të voglat më janar dhe shkurt.

Tabela 19. Numri i ditëve në vit me të reshura

Lokaliteti	0.1	1,0	10,0	x 0,1	lartësia max në vit	
Klina	108	69	16	13		

Periudha e lajmërimimit të borës është kryesisht prej muajit nëntor deri në prill

Është me rëndësi të thuhet se ky rajon për shkak të ndikimit të mediteranit i cili depërtion me anë të lumit Drini i Bardhë ,klima është mjaft e butë dhe nuk ka variacione karakteristike ekstreme në temperaturë të ajrit gjatë vitit.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## KARAKTERISTIKAT SEIZMIKE

Në territorin e komunës së Klinës janë vërejtur thuaja se të gjitha dridhjet seizmike të cilat janë bërë në hapësira me epiqendra te cilat e rrethojnë (Shkupi,Banjalluka,Bregdeti i Malit të Zi,Kopaoniku,Rumania,Shqipëria etj.)

Pasojat e dëmëve janë manifestuar me dëme të vogla materiale dhe gadi te parëndësishme në disa objekte më të vogla të ndërtuara nga materialet e dobëta ndërtimore .

Sipas interpretimit të hartave seizmike të hartuar në Entin Seizmik – Beograd ne vitin 1973 territori i komunës së Klinës është në ndikimin  $6^{\circ}$ -  $7^{\circ}$ (gradë) të intenzitetit seizmik MSC.

Gjithashtu sipas të dhënave kartografike me të cilat disponon komuna e Klinës shtrihen plasjet e mbuluara dhe pak të dukshme si dhe plasjet e mbuluara gjë që tregon karakteristika specifike tektonike të këtij subregjioni .

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## KARAKTERISTIKAT PEDOLOGJIKE

Ky subregjion tregon llojlojshmërinë e dukshme pedologjike e cila pasqyrohet në gjetjen e numrit më të madh të grupeve themelore të tokave dhe numrit të madh të njësive kvalifikuese të rendit të ulët si dhe të zvoglimit të tyre gjë që tërë territorit i jepë një pamje mozaike .

Nëse përjashtohet toka skeletore e cila paraqitet në vendin e saj ekzistues ,tokat tjera janë nga supstratet e bartura. Ato janë formuar pjesërisht nga sendimentet e liqejeve ,pjesërisht me bartjen e pluvio lokaleve e pjesërisht me bartjen recente të rrjedhave të ujit.

Prezenca e një numri të madh të tokave të cilat sipas karakteristikave dhe mundësive të shfrytëzimit në bujqësi dallohen mjaft e që është rezultati i ndikimit të faktorëve të ndryshëm të formimit.

Është me rëndësi edhe ndikimi i njeriut në shfrytëzimin e tokës gjë që shpesh herë mund të jetë negativ që shifet përmes mosruajtjes racionale të tokave produktive ,shfrytëzimi joracional i pyjeve me ç'rast shpëjtësohet procesi i erozionit.

## RRËSHINORET E EROUARA

Rëshinorë të eroduar gjenden edhe në verilindje të Klinës .Në kodrinat në formë relefore në të cilat gjindet kjo tokë, erozioni ka bartë pjesën më të madhe të humusit.

Këto toka janë të thellësisë mesatare dhe të cekët, me përbërje algirore mekanike me reaksion neutral deri në ate të dobët alkal,me përbajtje të zvogluar të humusit në horizontin e redukuar të humusit si dhe me përbajtje të ndryshuar të formës aktive të fosforit dhe kaliumit. Në shumicën e rasteve këto toka janë me vlerë të zvogëluar bujqësore dhe nuk mund të shfrytëzohen për kultivimin e të gjitha kulturave bujqësore.

Këto siperfaqe janë të bonitetit klasorë të III-të dhe IV-të.

## RRËSHINORET E FISNIKRUAR

Nga rrëshinoret e fisnikruara është rrethina e Klinës .Gjendet në elementet e rellefit të ngjashëm me rrëshinoret pa karbon, me të cilin shpesh gjendet në të njejtin kompleks. Kjo është një tokë mjaft e thellë ,me përbërje algirore mekanike,por diçka me e lehtë për punim se rrëshinoret me karbon, me reaksion neutral deri ne diçka më të thartë me variacione diçka më të mëdha në brendinë e humusit dhe forma aktive të fosforit dhe kaliumit se në rrëshinoren pa karbon.

Këto siperfaqe janë të bonitetit klasorë të III-të dhe të IV –të.

## REUDZINA

Gjenden ne veri të Klinës ,këto janë toka të cekëta depërtuese me karakteristika të dobëta të ujit,mjaft karbonizuese që nga sipërfaqja e varfër me humus dhe asimilative bimore. Këto toka kërkojnë masa të posaqme për mbrojtje nga erozioni. Siperfaqet më të mëdha në këto grupe të tokave shfrytëzohen si sipërfaqe punuese apo livadhe natyrore .Prodhimi bujqësorë është kryesisht i ulët dhe i pasigurtë dhe kërkon masa të mëdha përmirësuese në mënyrë që të mundësojnë prodhimin e sigurtë dhe racional.

Këto sipërfaqe janë të bonitetit klasorë të IV-të dhe VI –të.

## REUDZINA NGYRË GËSHTENJE

Në rrëthinen e Klinës gjenden disa komplekse të tilla .Në një profil pak më të thellë dhe në krahasim me reudzinën ,është mbajtësi i ujit më i mirë dhe mund të konsiderohet si tokë mesatarisht e mirë bujqësore.

Kjo tokë i nënshtrohet erozionit dhe gjatë shfrytëzimit të saj janë të nevojshme të mirren disa masa gjegjëse për mirëmbajtje.

Këto sipërfaqe janë të bonitetit klasorë të III-të dhe të IV –të.

## TOKAT MINERALO-MOÇALIKE GLEJORE

Përfshijnë luginën e rrjedhës së epërme të Drinit të Bardhë dhe Klinës .Këto toka janë kryesisht nën livadhe natyrale mirëpo ,mund të shëndrrohen në toka të mira punuese me rregullimin e shtratit të lumit dhe zvogëlimin e nivelit të ujërave nëntokësor.

Këto siperfaqe janë të bonitetit klasorë të IV-të dhe VI –të.

## TOKAT ALUVIALE

Është tokë e luginave dhe lumenjëve me përbërje të llojlojshme mekanike .Është toke aluviale me përbërje deltinore, janë toka më produktive që mundësojnë formën më intenzive të prodhimeve bujqësore .Mirëpo në disa pjesë të tokave aluviale për shkak të mosrregullimit të shtratit të lumenjëve shpesh vërvshohen apo dheu bartet me erozion anësorë ,kështu që këto sipërfaqe duhet sanuar me masa gjegjëse hidroteknike .

Këto sipërfaqe janë të bonitetit klasorë të I-rë dhe bëjnë pjesë në tokat me produktivitet të lartë bujqësorë .

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## KARAKTERISTIKAT HIDROGRAFIKE

Në komunën e Klinës lumi Drini i Bardhë rrjedhë si lum fushor me shtrat të ndryshuar. Në pranverë dhe vjeshtë kur të rreshurat janë më të mëdha ,respektivisht kur bora shkrihet, ky lum vërvshon nga shtrati dhe i vërvshon tokat afër bregut të lumit, duke marrë me vehte pjesën më kualitative të tokës.

Në periudhën e vegjetimit Drini i Bardhë është i ngushtë dhe është i thellë rreth 50cm përpos në drredha ku thellësia është më e madhe .Kjo është nga arsyja se uji i këtij lumi me anë të rrjetave dhe kanaleve mund të shpërndahet dhe të shërbejë për ujitjen e sipërfaqeve bujqësore. Deri në fshatin Kramovik (komuna e Rahovecit) lugina e lumit ngushtohet në 1km. Ndërsa thellësia është 100cm ndërsa në pjesën e poshtme të rrjedhës prej Kramovikut e deri në dalje të këtij lumi nga

territori i komunës së Rahovecit anët e luginave janë të buta dhe të përbëra nga margelet, rërat dhe argjilet pliocenike. Gjërësia e shtratit është 20-70m thellësia gjatë nivelit të ulët të ujit 0,5-2m ndërsa në dredha mbi 4m.

Nëpër qytetin e Klinës rrjedhë lumi me të njejtin emër i cili rrjedhë përgjatë tërë territorit të komunës së Skënderajt dhe në Klinë derdhet në Drinin e Bardhë. Në të kaluarën ky lumi ka vërvshuar dhe ka shkaktuar dëme, por me rregullimin e shtratit të lumit qyteti i Klinës më nuk ka patur probleme. Rregullimi i shtratit është nga derdhja në Dri deri te burimi i Jarinës, gjegjësisht, deri te ngushtimi natyral i lumit (gryka).

Lumi Kлина thahet gjatë verës dhe uji i cili rrjedhë në shtratin e tij paraqitet përsëri në burim në veri të stacionit të hekurudhës. Nga ky burim e deri në grykë lumi i Drinit të Bardhë në vendbanimin Kлина, në shtratin e vet ka gjithnjë ujë.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

Të dhënat nga hulumtimi në teren

## KARAKTERISTIKAT HAPËSINORE INXHINIERIKE

### SEIZMIKA

Sipas interpretimit të hartave regionale seizmike të vitit 1973 territori i komunës së Klinës hyn në 6°-7° (shkallë) të MSC. Është i evidentuar edhe ekzistimi i disa çarjeve të mbuluara apo pak të dukshme dhe mbulesave si dhe çarjeve të mbuluara gjë që tregonë specifitetin e karakteristikave tektonike të këtij subregjioni.

Pasojat e mundshme janë për 6° të MCS që do të thotë se për disa ndërtesa të ndërtuara nga guri i papërpunuar, shtëpitë e vjetra fshatare, ndërtesat nga çerpiqet, shtëpitë nga balta, mund të kenë dëmtime të shkallës së I -rë, e disa edhe demtime të shkallës së II -të. Në raste të rralla është e mundur që të lajmërohen edhe çarjet në gjerësi prej 1 cm.

Në tokën e lagësht në rajonet malore nganjëherë lajmërohen edhe rrëshqitjet e tokës dhe lajmërohen ndryshime në sasinë e ujit në burime dhe në nivelet e ujërave nëpër puse.

Për termetë të forcës 7° të MCS shumë ndërtesa me beton arme dhe shtëpi nga druri të ndërtuara mirë, marrin dëmtime të shkallës së I-rë. Shumë ndërtesa të rëndomta nga tullat e pjekura ndërtesat nga materiali i fabrikuar, ndërtesat nga gurët e gdhendur si dhe ndërtesat me konstruksion pjesërisht të drunjtë, marrin dëmtime të shkallës së II -të. Numri më i madh i ndërtesave nga gurët e papërpunuar, shtëpitë e vjetra fshatare, ndërtesat nga çerpiqet, shtëpitë nga balta, mund të kenë dëmtime të shkallës së III-të ndërsa në raste të jashtëzakonshme edhe të shkallës së IV-të. Në raste të posaçme kyçjet në përcuesit e ujit mund te demtohen dhe te lajmerohen çarje. Uji në rrjedhat turbullohet ndërsa lumi del në sipërfaqe, e niveli i ujit në puse ndryshohet dhe nganjëherë edhe shterret, mund të shkëputen edhe pjesët e bedemeve rënore dhe zhavorore.

### RRJEDHAT E UJIT

Të gjitha rrjedhat e ujit të vogla apo të mëdha të cilat kalojnë nëpër këtë territor, nuk janë të rregulluara, me përjashtime të vogla, prandaj gjatë ramjes së të rreshurave të pandërprera apo gjatë shkrirjes së borës, mund të shkaktohen dëme.

Për shkak të mos sigurimit të brigjeve, të gjitha këto rrjedha të ujërave dhe disa rrjedha më të vogla në disa vende rrënojnë brigjet, ndryshojnë drejtimin e shtratit duke bartë me veti një pjesë të madhë të tokës dhe

## UJËRAT NËNTOKËSORE

Është evident ekzistimi i ujerveve nëntokësorë gadi në tërë territorin e këtij rajoni që dokumentohet me numër të madh të puseve me të cilat shërbehen një numër i madh i vendbanimeve. Ujërat nëntokësorë nuk janë aq të forta, përpasë disa vende, përfshirë mund të jenë furnizues kryesorë të ujit, mirëpo ekzistimi i tyre është shumë i madh në pikëpamje të furnizimit me ujë, ndërsa në rajonet rrafshinore është element kufizues në fundimin dhe hidroizolimin e objekteve ndërtimore.

## EROZIONET

Duke ju falënderuar gjendjes së përgjithshme të vegjetacionit, bazës gjeologjike, pjerrësisë së terrenit, ndikimit të pavolitshëm të kushteve klimatiko-meteorologjike dhe hidraulike e sidomos ndikimit të njeriut, proceset e erozionit kanë marrë përpjesa shqetësuese sepse një pjesë e madhe e territorit është nën ndikimin shkatërrues të erozionit përfshakatë të ujërave vërvnues. Me erozion të kategorisë së III-të IV-të dhe II-të është përfshirë afér 50% e territorit të komunës së Klinës.

## TË RRESHURAT

Vlera mesatare e të rreshurave në Klinë është 540mm. ndërsa të rreshurat më të vogla janë në muajin Shkurt (4.0) e ato më të mëdha në Tetor (143.0).

## TEMPERATURAT E AJRIT

Temperatura mesatare vjetore e ajrit në Klinë është  $10.8^{\circ}$ . Maksimumi absolut lajmërohet në muajin korrik me  $37.0^{\circ}$ , ndërsa minimumi absolut në muajin shkurt prej  $(-11.8^{\circ})$  e temperatura e amplitudës absolute është  $46.1^{\circ}$ .

## MORFOLOGJIA E HAPËSIRËS

Në komunën e Klinës sipërfaqet më të mëdha shtrihen në lartësine mbidetare prej 500-700m, e pastaj pasojnë ato prej 500 dhe prej 700-1000 m. Ndërsa pjerrësitë janë prej  $10-15^{\circ}$  e ka pjerresi edhe prej  $2-5^{\circ}$ , mirëpo këto janë në sipërfaqe më të vogla.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## FLORA DHE FAUNA

Pjësën më të madhe të territorit të komunës së Klinës e përbëjnë rrafshinat dhe tokat pjellore. Një pjesë e vogël është nën kodra gjelqerore dhe pyje. Klima është kryesisht mesdhetare të cilën e mundëson lumi Drini i Bardhë me anë të së cilit depëtojnë ndikimet nga Deti i Mesdheut.

Të tërë territorin e kësaj komune e përshkojnë lumenjët, e më i rëndësishmi është Drini i Bardhë në të cilin rrjedhin të gjithë lumenjët të cilët përshkojnë këtë territor :lumi i Istogut/Burimit, Bistrica e Pejës, Bistrica e Deçanit, Klina dhe Mirusha .

Me vetitë e saja fiziko gjeografike territori i Klinës ka kushte të volitshme përfshirë zhvillimin e jetës bimore dhe shtazore. Diferenca e lartësisë mbidetare prej 300 deri 700 m mundëson shumëlojshmerinë në botën bimore dhe shtazore.

## FLORA

Klina është e njojur për pemët dhe perimet kualitative. Janë të njojura mollat dhe kumbullat e kësaj ane në këtë rrafshi pjellorë kultivohet sasi e madhe e lakrave . Livadhet dhe kullosat si mbulesa të përhershme të gjelbërtë në pikëpamje biologjike paraqesin kategorinë më të rezistueshme të sipërfaqeve bujqësore, dhe pas pyjeve janë regjeneratorë më të mirë të veticë pozitive të tokës me ketë edhe regulatorë të mirë të mbajtjes së drejtëpeshimit të natyrës.

Pyjet dhe zabelet, si siperfaqe të pashfrytëzuara ekonomike ,lajmërohen me një insolacion më të fortë dhe ëshhtë e perfaqësuar me lisa pulmonare ,shkozë të zezë ,qarr dhe frashër. Këto pyje janë kryesisht të ulëta dhe të tipit të pasur.Largësia reciproke e trupave të këtyre drunjave është mjaft e madhe, kështu që mundësohet rritja e kaqubave ,gërrmusheve dhe vegjetacionit të barishteve.

Në territorin e kësaj komune janë të pranishme edhe thatësirat të cilat nganjëhere zgjasin edhe nga dy muaj duke shkaktuar dëme të mëdha zonave bujqësore.

Nga llojet e kaçubave në territorin e komunës së Klinës gjenden këto: trandofilet,bare veshi,adonidet,sherbelet e drejta ,shpargullet dhe bozhuret.

## FAUNA

Peshqit të cilët lajmerohën në këto ujëra janë :bërcaku,ngjala,mustaku,trofta e danubit dhe trofta projesh ne ujërat e Drinit të Bardhë ,përveq peshqive ka edhe gaforre,bretkoca dhe breshka.

Nga kafshët shtëpiake në këtë territor kultivohen gjedhet,kuajt,berret,derrat dhe shpezët shtëpiake.

Komuna e Klinës ka kushte natyrore për zhvillimin e turizmit dhe gjuetisë.

Begatshmeria e pyjeve lisore ka ndikuar që ky territor të jetëi pasur me derra të egër dhe dhi të egra.

Sipërfaqet me livadhe ,kullosa dhe kaçuba mundësojnë kushte të volitshme për zhvillimin e gjuetitisë së egërsirave të imëta –lepuje.

Përpos keëtyre ne këtë territor lajmërohen vjedullat,ketri,ujqit,vidrat dhe kaprojt,nga shpezet lajmerohen:

qukapikëthi i larmë,bilbili,kukuvajka,thëllënza,fazani,kumrija,krahëthata dhe mullizera .

Shpezët sezionale të këtij territori janë gjeraqina,shkurtëza ,borsi,gushkuqja,çyqja etj.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

## RESURSET NËNTOKËSORE

Në territorin e komunës së Klinës janë hulumtuar rezerva të nevojshme për zhvillimin e miqjeve të mëdha të thëngjillit, të rezervave të boksitit, zhavorrit dhe argjilës për prodhim të tullave.

## THËNGJILLI

Shtresat e thëngjillit gjenden mes komunave Klinë dhe Istog. Terreni të cilin e përshkon është kodrinorë i ulët me lartësi mbidetare 400 – 500 m. Këto shtratimet të thëngjillit Klinë – Tuçep gjenden në pjesën veri-perëndimore të basenit të Pejës, që është edhe pjesë përbërëse e basenit të rrafshit të Dukagjinit. Nga hulumtimet, thëngjilli përfshinë një sipërfaqe prej  $100 \text{ km}^2$ . Hapësira në të cilën lajmërohet thëngjilli gjendet kryesisht ndërmjet hapësirës së Klinës në jug, Jashanicës në lindje, Tuçepit në veri dhe Drinit të Bardhë në perëndim.

Shtresat e thëngjillit gjenden në thellësi prej 0 – 23 m. Thellësia mesatare për tërë fushën Klinë – Tuçep është afro 140 m. Pjesën e sipërme të shtresës së thëngjillit e përbëjnë: argjila e butë, argjila ranore kokërmirë, argjila laporit dhe laporcët.

#### BOKSITI

Shtresat e boksitit gjenden afro 10 km në jug – lindje të qytetit të Klinës, në brez kodrinor. Ky territor përfshin një sipërfaqe prej  $15 \text{ km}^2$ .

#### ZHAVORRI DHE RËRA

Shtratimi i zhavorrit gjendet 6 km në jug të Klinës, përkatësisht në territorin e fshatit Volljakë. Ky shtratim shtrihet në pjesën buzë bregut të djathtë dhe të majtë të Drinit të Bardhë dhe përfshin një sipërfaqe prej 40 ha në bregun perëndimor dhe 20 ha në bregun lindor të lumit Drini i Bardhë

#### ARGJILA PËR TULLA

Shtratimi i argjilës gjendet 4 km në perëndim të qytetit të Klinës, përkatësisht në territorin e Jagodës, ne afërsi të hekurudhës dhe 2 km larg rrugës Prishtinë – Pejë.

Trashësia e shtratimit të argjilës sillet prej 6 – 18.6 m.

Burimi: Plani Hapësinor për Istog, Klinë, Rahovec dhe Suhareke – EUP, Prishtinë 1984

Harta20. Resurset nëntokësore

